

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
INDEKSIA E ADMINISTRATËS - USTRUKCJA ZA ADMINISTRACIJU

Relaz/Relaz: 133
Data/Date: 16 - 04 - 2026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e dytë e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 18.02.2026, në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Besarta Qadraku, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Mirlinda Krasniqi, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Jetmir Berisha, Burim Berisha, Ali Topalli, Etnik Berjani, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Rrahim Tërnavë, Valon Murseli, Ermal Dumani, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Bashkim Krasniqi, Dashnim Bajrami, Ali Ismaili, Driton Ademi, Vildane Latifi dhe Radoman Dedorevic.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Valon Prebreza - Kryetar i Komunës, Shpend Bardiqi - Nënkretar i Komunës, Shefqet Zogaj - Drejtor për Administratë, Albana Gashi - Drejtoresha për Shëndetësi, Adriatik Zeqiri - Drejtor për Arsim, Taulant Kelmendi - Drejtor për Planifikim Urban, Bardhyl Kojcici - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Durim Hajra - Drejtor për Inspektorat, Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Gëzim Zogjani - Drejtor për Pronë, Artan Hajrullahu - Drejtor për Gjeodezi dhe Kadastër, Pranvera Merovci - Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Resul Makreshi - Drejtor për Teknologji Inovacion dhe Integritet Evropian

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe Media.

REND DITE

1. Betimi i anëtares së re të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 22.01.2026.
3. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
4. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.
5. Propozim për shpalljen e interesit publik për Ngastrat Kadastrale në Zonën Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës.
6. Propozim për ndihmë financiare të fëmijëve me autizëm dhe sindromin down.
7. Raporti i Auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.
8. Raporti i Auditimit të performancës në procesin e lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë-Kosovës.
9. Informatë për Performancën Komunale në vitin 2024.
10. Propozim për shqyrtimin e Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.
11. Propozim për themelimin e Komitetit për Komunitete.

12. Propozim për ndryshim-plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
13. Propozim për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik.
14. Propozim për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit.
15. Propozim për themelimin e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.
16. Propozim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
17. Propozim për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra.
18. Propozim për shqyrtimin e Kërkesës Nr. 01-104/02-0004317/26, të datës 10.02.2026, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026
19. Propozim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029.
20. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, falënderit shumë për pjesëmarrjen, sipas konstatimit kemi kuorum për fillimin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës, pra po i hapim punimet e mbledhjes se dytë të Kuvendit të Komunës për vitin 2026, sipas materialit që e keni pranuar i kemi 16 pika të rendit të ditës dhe dy pika tjera shtesë të rekomanduara nga mbledhja e Komiteti për Politikë dhe Financa. Pa humbur kohë po i lexoj pikat e rendit të ditës, pastaj pikat shtesë dhe po fillojmë me mbledhjen, pika e parë e rendit të ditës është: Betimi i anëtarës së re të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, pika e dytë është [Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës](#) e mbajtur me datën 22.01.2026, pika e tretë është ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, pika e katërt është Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjeksisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, pika e pestë është Propozim për shpalljen e interesit publik për Ngastrat Kadastrale në Zonën Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës, pika e gjashtë Propozim për ndihmë financiare fëmijëve me autizëm dhe sindromin doën, pika e shtatë Raporti i Auditimit të Jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2024, pika e tetë Raporti i Auditimit të Performancës në procesin e lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë-Kosovës, pika e nëntë është Informatë për Performancën Komunale në vitin 2024, pika e dhjetë Propozim për shqyrtimin e Projekt-Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026, pika e njëmbëdhjetë Propozim për themelimin e Komitetit për Komunitete, pika e dymbëdhjetë Propozim për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik, pika e trembëdhjetë Propozim për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit, pika e katërbëdhjetë Propozim për themelimin e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, pika e pesëmbëdhjetë Propozim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe pika e gjashtëmbëdhjetë Propozim për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra, pastaj pika e shtatëmbëdhjetë është: Të ndryshme. Sipas rekomandimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa i kemi edhe dy pika shtesë të propozuara nga ky komitet, e kemi Propozimin për procedim dhe shqyrtim në Kuvendit e Komunës për shqyrtimin e Kërkesës Nr. 01-104/2 të datës 10.02.2026, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026, si dhe pika tjetër shtesë: Propozimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029, rekomandimin po e lexoj si vijon: për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës për themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi për mandatin 2025-2029, në përbërje si vijon: Valon Prebreza - Kryetar i

Komunës, Bekim Zogjani - Komandant i Stacionit Policor, Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame, Përfaqësuesi i Kishës Ortodokse Serbe, Përfaqësuesit e komuniteteve ashkali, egjiptian, serbë dhe romë, Adratik Zeqiri - Drejtori i Arsimit, Izja Mjeku - Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ejup Qyqalla - Përfaqësues i Emergjencave Civile, Një përfaqësuesi i EVSB-së, nga një përfaqësues i KLSP-ve, Lindita Dervisholli Prebreza - Zyrtare për Barazi Gjinore, Sllaxhane Lazic - Shefja e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, nga një përfaqësues i mediave, biznesve, personave me aftësi të kufizuara dhe shoqërisë civile. Këto janë dy propozimet shtesë që kanë ardhur si rekomandime nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Unë po e hapi diskutimin, nëse dikush ka diçka të shtojë për pikat shtesë ose të ndryshoj, në pikat e rendit të ditës.

Kosovar Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizja Vetëvendosje, pajtohem me rendin e ditës dhe dy rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, falënderit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, përshëndetje kryetar, koleg asambleistë dhe ju të pranishëm të tjerë, sa i përket pikave të rendit të ditës, ne pajtohem me parim me rendin e ditës, të cilin e kemi sjellë si Ekzekutiv i Komunës, po ashtu edhe me dy pikat shtesë, jemi të gatshëm t'i përkrahim, por e kemi edhe një pikë shtesë, e cila konsiderojmë që është ende e paplotësuar dhe ka të bëjë me plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, me emrin nga subjekti jonë politikë Lidhja Demokratike e Kosovës, pasi që ka mbetur si pikë e papërfunduar nga mbledhja e fundit, praktika nga komunat tjera zakonisht janë që pikat e papërfunduara të hyjnë në fillim të mbledhjes dhe nuk ka shumë diskutim, është emër që nëse i merr votat mire, nëse jo vazhdojmë tutje, kërkojë që pika për plotësimin e vendimit për themelimin e Komitetit të jetë si pikë e tretë e rendit të ditës, në mënyrë që të shtjellohen temat e rendit të ditës, që janë paraparë për sot.

Kosovar Ademi: Te nderuar kolegë asambleistë, drejtor dhe ju të pranishëm deshta të ndërlihem, me kërkesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës, parimisht ne jemi për të procesuar me këtë, por meqenëse komitetet janë prej pikës njëmbëdhjetë deri gjashtëmbëdhjetë, propozimi ynë është që të jetë si pikë e fundit, si vazhdimësi e pikave të komiteteve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A jeni dakord për propozimin e Kosovar Ademit?

Laureat Gojnovci: Kryesues, nëse me lejoni unë thashë që kjo të bëhet praktikë edhe për mbledhjet e ardhshme, që pikat e papërfunduara nga mbledhja e kaluara secilën herë të trajtohen me prioritet për ndryshe, ne nuk kemi ndonjë qëllim të caktuar, që të vendoset kjo pikë e dytë ose shtatëmbëdhjetë, por me rëndësi është, që të krijohet një praktikë që pika e papërfunduar të trajtohet gjithmonë në fillim para 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare'. Nëse ju pengon që të vendoset si pikë e tretë, mundemi ta diskutojmë tek Komiteti për Komunitete, pasi që janë dy Komitete të Përherëshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e vendosim pra pikë të dymbëdhjetë të rendit të ditës si plotësim i anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa nga Lidhja Demokratike e Kosovës, por një sqarim duhet të jap para jush, në mbledhjen e kaluar kërkuam që të plotësohet ky numër, nuk e patëm mirëkuptimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, për me plotësuar me kohë, kishë qenë mirë që kur ka qenë koha të plotësohet, megjithatë ne e kemi dërguar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kjo Ministri e ka kthyer si të kompletuar ligjërisht në rregull vendimin tonë, shpresoj që herën tjetër të jemi bashkëpunues dhe t'i tejkalojmë këto pengesa procedurale. Si pikë

e dymbëdhjetë e rendit të ditës do të zhvendoset plotësimi, kompletohet edhe me dy rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Migjen Kolshi: Përshëndetje Kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket pikave të rendit të ditës, ne i përkrahim se bashku me pikën e Laureatit dhe pikat shtesë, ne si Grup Parlamentarë kemi kërkesë që anëtari jonë tek Komiteti për Zhvillim Ekonomik, të largohet nga ky komitet dhe të hynë tek Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, për arsye se këto janë dy komitete më të rëndësishme dhe kërkoj nga ju që të përfaqësohemi në këtë komitet.

Ali Ismaili: Përshëndetje Kryetar, Nënkryetar, Kryesues dhe ju kolegë asambleistë, që të jem korrekt ka të bëjë me ty Kryesues personalisht, për katër vite rresht nga pozita e opozitës, që keni qenë sa herë kemi sjelle pika jashtë rendit të ditës, i keni kundërshtuar dhe është paradoksale sot një gjë e tillë, që e keni kundërshtuar për katër vite, sot po e zbatoni të njëjtën ju, po sjellni pika të rendit të ditës jashtë rendit të ditës dhe është mire, që rendi i ditës tani e tutje mbi bazën e punës që e kemi, pikat të bëhen me kohë dhe të ju vijë asambleistëve me kohë, sepse çdo pikë e rendit të ditës që vjen jashtë rendit të ditës, asambleisti do të ketë problem me lexuar rendin e ditës, me shqyrtuar dhe ka me pas problem si me vendos me atë pikë të rendit të ditës. Andaj është kërkesë e imja që të mos bëhet praktikë në mbledhjet e ardhshme, sepse keni qenë të zhurmshëm dhe nuk i keni votuar pikat jashtë rendit të ditës dhe mos veproni njëjtë sikur keni kundërshtuar. Sa i përket pikave të rendit të ditës, është një rend i madh i pikave të rendit të ditës, por janë çështje teknike dhe mendoj se do të i'a dalim shumë shpejtë dhe nuk jemi kundër as kësaj pike të rendit të ditës, që ka të bëjë me Këshillin e Bashkësisë Islame, as nuk jemi kundër pikës tjetër që ka të bëjë me Këshillin për Siguri në Bashkësi, por jemi kundër në qoftë se vijnë jashtë rendit të ditës shumë pika.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Ali Ismaili, ju keni qenë në kualicion me pushtetin e kaluar për katër vite dhe i keni pasur dy mandate tjera para këtij mandati dhe s'keni mundur ta ndyshosh, këtë formë, normalisht ne i kemi kundërshtuar ato pika që kanë ardhur aty për aty. Ju keni qenë që pika të rendit të ditës të ardhura nga Komiteti për Politikë dhe Financa, të cilin edhe me ligji i'a mundëson me dërguar rekomandime të tilla. Komiteti për Politikë dhe Financa mundet t'i anuloj krejtë pikat e rendit të ditës dhe vjen si rekomandim, që nuk e mbështesin asnjë pikë, kështu që kjo nuk është jashtë procedurave, ne i kemi mbajtur punimet, ju keni qenë anëtar i atij komiteti dhe keni qenë pjesëmarrës në atë mbledhje, jeni i njoftuar direkt me këto pika shtesë të rendit të ditës, nuk besoj që ka ndonjë problem por nëse vijnë sot pikat e rendit të ditës, pa u trajtuar në komitet, atëherë në një aspekt të jep të drejtë në këtë vërejtje që ju e keni.

Ali Ismaili: I nderuar Kryesues sa për sqarim është mandati im i katërt dhe për dy mandate kam qenë në opozitë, vijë nga Partia e Drejtësisë dhe mandatin e tretë me një votë Lidhja Demokratike e Kosovës, Ekzekutivi në kohën e z. Burim Berisha, ka vendosur që të më bëjë Kryesues të Kuvendit, gjë për të cilën jam falënderues, kam udhëhequr me Kuvendin dhe mendoj që jam kam dalur shumë mirë, kam qenë një shembull dhe gjithmonë më keni lavdëruar edhe ju si Kryesues për arsye të unitetit, që kam bërë në Kuvend dhe jam krenar me atë pjesë që kam udhëhequr. Jam këtu për secilën gjetje, që ju mendoni se kam udhëhequr keq me ma thanë zyrtarisht dhe jo zyrtarisht, sepse mendoj që kam qenë shembull i pas luftës si Kryesues i Kuvendit në raport me Kuvendin. Me Ekzekutivin e Komunës s'kam pasur marrëveshje, s'kam pasur drejtori, kemi udhëhequr me Kuvendin bashkarisht me të gjitha subjektet politike dhe kemi kaluar jashtëzakonisht mirë, mirëpo e vërteta duhet thënë Kryesues, për katër vite pikat e rendit të ditës

që i kam sjellë jashtë rendit të ditës, duke i përfshirë edhe ato që i kam kaluar përmes Komitetit për Politikë dhe Financa, siç e cekët edhe ju që kemi shkuar në bazën e procedurave në mënyrë të rregullt ju personalisht nuk i keni votuar këto pika, sepse i keni konsideruar që kanë ardhur jashtë rendit të ditës, unë vetëm thashë, që në të ardhmen të mos bini në kundërshtim, me veprimet e juaja si Kryesues i Kuvendit. Ju me të drejtë keni kritikuar nga opozita kur keni qenë, mirëpo kam konsideruar që kanë qenë pika të nevojshme në dobi të komunitetit, e që edhe sot konsideroj, që është pikë e nevojshme dhe në dobi të komunitetit Këshilli i Bashkësisë Islame dhe Këshilli për Siguri në Bashkësi, vetëm apelova që herave të tjera të jeni të kujdesshëm, me qëllim që ato që i keni kundërshtuar mos t'i sjellni, sepse ju vetë nuk i keni votuar kurrë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Ali Ismaili, ne mundemi të flasim pafundësisht për këtë çështje, por prapë po e them që ju keni qenë anëtar i atij komiteti, keni diskutuar vetë për secilën pikë shtesë, materiali ka ardhur të premtën është mbajtur komiteti, koha ka qenë e mjaftueshme për t'i lexuar dy paragrafët e propozimeve, por gjithsesi do e marim këtë shqetësim tuajin, me gjithë respektin falënderit shumë.

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë, meqenëse jemi në fillim të mbledhjes për arsye parimore është mirë që mos të ketë pika shtesë të rendit të ditës, këto pika e arsyetohen vetëm kur kanë ndonjë urgjencë. Tek pikat shtesë sa i përket mbulimit të shpenzimeve të varrimit po vërehet se datën e protokollit, e ka me datën 10.02.2026, na ftesën për këtë mbledhje e kemi marrë po të njëjtën ditë, prandaj mundësitë që ky material në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, me na ardhur si pjesë e Kuvendit kanë qenë të nevojshme për të mos krijuar arsyeshmëri në lidhje me pikën shtesë për këtë shqyrtim, prandaj sot do t'i përkrah këto dy pika shtesë, por në mbledhjet e radhës në emër të Nismës Socialdemokrate, do t'i përkrah vetëm ato pika shtesë, që kanë urgjencë dhe kur materiali është i kompletuar, pra kjo pikë ka mundur të mos jetë pikë shtesë, por me na ardhur të njëjtën ditë kur është ardhur mesazhi për mbajtjen e mbledhjes. Materiali nuk është i kompletuar, ka propozime që kanë implikime buxhetore dhe është dashur të jenë më të detajizuara, në mënyrë që ne të marrim një aprovim që është i domosdoshëm, mirëpo i pakompletuar kështu që sot po e përkrah, herave të tjera vetëm ato pika që paraqesin urgjencë mund të marrin përkrahjen e Nismës Socialdemokrate.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Falënderit shumë z. Driton Ademi, nëse s'ka diskutime tjera e kemi propozimin për plotësim-ndryshimin në përbërjen e anëtarëve të Komitetit dhe propozimin e z Migjen Kolshi. Migjen kur të vijmë tek pikat e rendit të ditës mundemi me trajtuar, për ndryshe me krejtë këto rekomandime që u dhanë deri më tani, edhe me pikat shtesë dhe me pikën shtesë për plotësimin e komitetit, si pako po i votojmë kush është për.

U votua unanimisht nga pranishmit, gjithsej njëzet e nëntë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u votua rendi i ditës me dy rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe pikën shtesë të evidentuara në rendin e ditës.

Pika e parë (1) - Betimi i anëtarës së re të Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani sipas ligjit e formojmë komisionin për zhvillimin e procedurës.

Kosovar Ademi: Ne propozojmë znj. Arlinda Mekolli, si anëtare të Komisionit për verifikimin e mandateve.

Mirlinda Krasniqi: Ne propozojmë z. Laureat Gojnovci për anëtar të Komisionit për verifikimin e mandateve.

Rrahim Tërnavaj: Ne propozojmë z. Ermal Dumani për anëtar të Komisionit për verifikimin e mandateve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas takimit të Komisionit, ftoi përfaqësuesin e Komisionit për verifikimin e mandatit znj. Arlinda Mekolli, që të jap vlerësimin.

Arlinda Mekolli: Përshëndetje për të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës, me datën 10.02.2026, është marrë vendim nga Komisioni Qendror Zgjedhor, për znj. Besarta Qadraku, e cila e zëvendëson znj. Hasime Kostanica, ne si Komision verifikuam listën e Komisionit Qendror Zgjedhor dhe vendimin e datës 10.02.2026, andaj janë plotësuar kushtet ligjore për leximin dhe nënshkrimin e Deklaratës së Betimit nga anëtarja e re e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë për konstatimin, ftoj anëtarën e re të Kuvendit znj. Besarta Qadraku, që të lexoi Deklaratën e Betimit.

Besarta Qadraku: Unë Besarta Qadraku, betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime dhe me ndërgjegje sipas ligjit detyrat dhe do t'i ofroj autorizimet e mia si anëtare e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë. Betohem.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë znj. Besarta Qadraku, të urojmë suksese dhe punë të mbarë, nga ky moment keni të drejtë vote për të gjitha pikat e rendit të ditës.

Pika e dytë (2) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 22.01.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe aprovim Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 22.01.2026, ju ftoi që të jepni vërejtjet apo sugjerimet e juaja. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: Sa unë e kam shikuar procesverbalin, ka disa mungesa në dialog, që nuk janë inkorporuar në proceverbal. Parimisht ne e votojmë për.

Laureat Gojnovci: Falënderit Kryesues, është po thuaj se e njëjta arsye, parimisht e votojmë për, por ka disa momente mospërputhje me atë çka ne kemi folur, por mendimi im është se janë nuanca të vogla.

Valon Murseli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, parimisht ne e votojmë me disa vërejtje, sidomos tek pika e pesëmbëdhjetë është devijuar komplet fjalia ime, e kam dërguar me vërejtje dhe besoj që do të merret parasysh, të evidentohet në ekstrakt sipas vendimit të Kryetarit të Komunës, thuhet se ky vendim, është dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe nuk është kthyer asnjë vendim deri tani, që do të thotë në heshtje, është aprovuar ky vendim, ose jo, edhe që Kuvendi nuk ka të drejtë për lejimin e mjeteve financiare, nëse marrim staf për vitin 2026 të jetë në bazë të këtij buxheti që e ka ndarë Kuvendi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunës: Po patjetër z. Valon Murseli, do të merret parasysh vërejtja. Dikush tjetër a ka diçka të shtoj rreth tekstit, nëse jo atëherë vazhdojmë me votim, kush është për. U votua unanimisht nga pranishmit, gjithsej tridhjetë e një anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u votua 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 22.01.2026', me përmirësimet e cekura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Pika e tretë (3) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani fjala është për ju asambleistë.

Laureat Gojnovci: Falënderit Kryesues, nuk po e shoh as Kryetarin e Komunës, as Nënkryetarin e Komunës prezent në sallë, shpresoj që të kthehen sepse kam pyetje, nuk po e shoh as Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kështu që përgjegjësinë po ta delegoj ty Kryesues, me organizimin e mbledhjes solemne, që është mbajtur dje është marrë ai dhe ka qenë për keqardhje, mënyra si është organizuar ajo mbledhje, më shumë ka qenë një program artistikë, që nuk ka asnjë lloj organizimi sidomos njerëzve që e kanë vendin aty, se mbledhja solemne bëhet për Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit, asambleistët dhe Drejtorat e Komunës. Pasi erdhi Kryetari në sallë, tani Kryetar unë pyetjen deshta të ja bëja për Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, sepse ai ka qenë organizatori i mbledhjes solemne, që është mbajtur dje, ne jemi ofenduar në mënyrën e trajtimit brenda asaj mbledhje solemne, na nuk e kemi ditur ku kemi me u ulur dje, në rreshtin e parë përjashtuar dy - tre figura që e kanë merituar të jenë aty, të tjerët kanë qenë figura, ndoshta fare të parëndësishme me u respektuar në atë mënyrë, jam ndier shumë keq edhe për Drejtorët Komunal, sepse kanë një pozitë që ka një peshë. Asambleistët e Lëvizjes Vetëvendosje, ishin ulur në rreshtin e parë, ndërsa ne partitë tjera do në rreshtin e dytë, do të tretin e disa në fund, kjo është mësim i mirë për neve për herat e tjera, sepse pa u specifikuar mënyra e organizimit, ne nuk do të marrim pjesë. Kemi dashur të nderojmë komunën, vetën, Kosovën, përvjetorin e pavarësisë, por jemi ndier të ofenduar. Tani po kaloj tek problematikat që kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve, kryetari në mbledhjen e kaluar më ka adresuar mua një çështje që s'kam fare përgjegjësi, ka të bëjë me hedhjen e një sasi dhe te ura e fshatit Lismir, për të cilën çështje jam interesuar dhe kam informacione, se si ka ardhur deri aty dhe ka dale, që unë e kam larguar edhe Njësinë e Policisë në Fushë-Kosovë, por edhe Drejtorinë e Inspektoriatit, nga këto dy institucione qytetari ka marrë dënim, kaq kam mundur të bëjë nga pozita e asamblesitit, sepse në videon të cilën e keni publikuar në fund, të preme del kogja vrazhdë dhe uroj që sa më shpejtë të filloj transmetimi në Youtube, kjo është sa i përket dheut unë tani, po të pyes në tunellin e fshatit Lismir, gjatë vërshimeve kur është thyer një tunel që ka një kohëzgjatje ndërtimi, ndoshta më shumë se njëzet vite, kur është shpuar ai tunel dhe kur është dëmtuar pjesa e lartë, që ne që kalojmë andej dhe një pjesë e mirë e fshatrave, që e lidhin Komunën e Fushë-Kosovës përmes fshatit Lismir, a keni ndërmarrë masa dhe a keni dhënë leje aty, sepse tani unë mundem të ju akuzoj, unë juve sikur ju mua se keni lejuar me shpuar dhe me dëmtuar atë tunel dhe sot pas çdo reshje shiu dhe kur ka temperatura të ulta, bëhet shumë rrezik me kaluar me automjete. Më e keqja është se që dy muaj aty, nuk është marrë asnjë veprim, shpresoj të trajtohet rasti në polici dhe përgjegjësitë të dënohen, sepse ajo pronë publike është duke shkaktuar probleme për ata banorë. Pyetje kam për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorin e Arsimit, deshta ta pyes si është puna me drunjë nëpër shkolla, a ka sasi të majtueshme te drunjëve nëpër shkolla për tu tejkalluar sezona e dimrit apo janë hargjuar, i keni shpërndarë drunjët për familjet që janë prekur gjatë vërshimeve. Nëse i keni shpërndarë qysh është proklamuar, a keni bërë shkelje, sepse drunjët kanë qenë të destinuar për shkolla, ka rrezik të mbesin shkollat pa drunjë, pa nxemje. Kryetar keni mbetë pa u përgjigjur në pyetjen e një kolegu këtu, e keni dhënë premtim që Nënkryetari i Komunës dhe 50% e Drejtorive do te jenë gra, pse nuk janë gra, ose sa % janë gra? E kam pyetjen për vendimet e bonuseve, është i publikuar në ueb-faqe vendimi i parë, i cili e shfuqizon totalisht vendimin e Kryetarit të kaluar, mandej është një vendim që i hjek do pika, që bëjnë pjesë në shfuqizimin e vendimit të parë, a është bërë gabim hera

e parë, sepse disa pjesë të vendimit janë shfuqizuar, apo pse është ardhur deri te përmirësimi i shfuqizimit të vendimit të parë, tani Kryetar nëse ai vendim është i keq dhe ka ndodhë shkelje atë vendim në Kuvend e Komunës e kemi marrë, shfuqizone sepse i keni votat. E kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, me sa kam kuptuar është Kryesues i Aksionarëve në Kompaninë ‘Pastrimi’, dhe së bashku me aksionarët e tjerë keni marrë ‘Vendim për emërimin e përkohëshëm të një anëtare të Bordit në Kompaninë ‘Pastrimi’, a jeni në dijeni, se keni shkel ligjin drejtor, sepse Ligji për Ndërmarrje Publike për anëtarët e Bordit është shumë i saktë, që tri vitet e fundit nuk guxon me qenë aktivisht në politikë, unë kam qenë Kryesues i Aksionarëve dhe në kohën kur Kryetari ka aplikuar për anëtarë të Bordit dhe një prej arsyeve që z. Valon Prebreza, nuk e kemi larguar nga gara, ka qenë që nuk kemi gjetë që ka qenë në rrugë politike, brenda Lëvizjes Vetëvendosje, ju udhëzoi ta shikoni ligjin sepse është shumë i qartë dhe mendoj që anëtarin e Bordit, që e keni emëruar, e ndalon pozita, që e ka pasur deri në dhjetor 2025, të merr atë pozitë dhe ju ftoj ta trajtoni sipas ligjit.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndetje Kryetar, Kryesues, kolegë asambleistë, unë i kam disa pyetje të qytetarëve për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, rruga te Stacioni i Policisë nuk ka ndriqim, nxënësit lëvizin andej dhe ka qenë endacakë, e kanë edhe atë problem dhe problemi tjetër rruga ‘Një Tetori’, në Sllatinë të Vogël dhe rruga te pishat nuk ka ndriqim, është më shumë se një muaj, që ka defekte dhe Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, kam pyetje por nuk po i kthejnë përgjigjet në email hiq nga mbledhjet e kaluara, kështu që të kisha lutur Kryetar dhe Kryesues, të jenë më të përgjegjshëm, sepse ne përfaqësojmë dikë që vijmë këtu, ja bëjë pyetjen z. Durim Hajra, a ka leje të parkimit në Fushë-Kosovë, apo kanë vetëm pëlqim për ngarkim edhe shkarkim të kamionave me mallëra, a kanë pëlqim për kona që i bllokojnë bizneset dhe i kërcënojnë qytetarët, pse i parkojnë automjetet aty. Për Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës prej rreth-rrotullimit në Fushë- Kosovë, e deri te hekurudha është rreziku i gropave dhe automjetet duke ikur nga gropat, mund të shkelin fëmijët që shkojnë në shkollë aty, kur e keni ndër mend mi sanuar ato gropat dhe rruga kryesore që është me Ministrinë e Infrastrukturës, ju e keni obligim me njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës për rrugën, që është prishur në Sllatinë të Madhe poshtë te rreth-rrotullimi aty është rreziku, se çdo javë ka aksidente duke ikur nga gropat. Kamerat sot po i shoh, mirë shumë, tenderë a ka pasur? Pse nuk është publikuar? Ku postohet dhe sa ka qenë çmimi i kompanisë, që e ka fituar dhe a ka pas konkurrencë tjetër apo vetëm kjo që e ka fituar tenderin, pse nuk është publikuar në ueb-faqe?

Migjen Kolshi: Falënderit Kryesues, para se të bëjë pyetje deshta të lidhem me atë që e theksoi z. Laureat Gojnovci lidhur me organizmin e mbledhjes së djeshme, dua të them që ka pasur njerëz të ulur në rreshtin e parë, që nuk e di si janë ulur aty dhe Kryetari i Invalidëve të Luftës ka mbetur në këmbë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunës: Më fal por duhet të përmirësoj, sepse nuk është e vërtetë që ka mbetur në këmbë.

Migjen Kolshi: Vazhdojmë me pyetjet tani Kryetar në mbledhjen e kaluar më keni thënë se përgjigjet, do t’i jap me shkrim, nuk e di a keni harruar, sepse nuk mi keni dhënë përgjigjet, pyetja ime ka qenë monitori i komunës shfrytëzohet për shërbime komunale për qytetarët, apo ka drejtë të shfrytëzohet edhe për parti politike, pyetja tjetër ka qenë për premtimin elektoral që e keni bërë që 50% e drejtorive me qenë gra dhe Nënkryetari i Komunës me qenë grua, pyetja tjetër nga mbledhja e kaluar është lidhur me ‘Kosova Med’, me sa punëtorë e keni marrë ‘Kosova-Medin’

dhe sa janë tani? Ju kërkoj Kryetar të shikoni buxhetin e kaluar dhe në fshatin Harilaç, çfarë premtime ka sepse nuk ka ndarje të mjeteve për fshatin Harilac, kështu që me rishikim të buxhetit të propozohet të ndahen mjete financiare, sidomos për rregullimin e shkollës, sepse është në gjendje të mjerueshme. Kryetar dua të bëjë një pyetje ose kërkesë, edhe pse në kushte normale, nuk ish dashtë të bëhet por kam një arsye që është disa portale që janë shfaqur në Fushë-Kosovë, nuk lanë njeri pa degraduar duke filluar nga fushata me asalmbeistë, që janë të pranishëm në sallë, nga dy persona të cilin t'i njërin e keni bërë Drejtor të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe tjetrin Këshilltarë Komunal. Ata me emëra janë z. Rilind Berisha dhe z. Ylber Kelmendi, të lutem si qytetarë Kryetar ndali këta njerëz se janë duke i shqetësuar familjet, unë jam drejtuar edhe në polici e prokurori për këtë çështje dhe nëse nuk ndër merren masa do të kemi probleme të mëdha.

Valon Murseli: Falënderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë ju, unë kam disa pyetje nga qytetarët dhe bizneset, një nga pyetjet kryesore është kur do të fillojnë punimet në rrugën 'Fehmi Lladrovci' ose rrugën përgjatë Hekurdhës përmes Projekt-Buxhetit për vitin 2026 të Republikës së Kosovës, janë ndarë mjete buxhetore dhe kur pritet të filloj, pasi gjendja e saj dihet dhe është një projekt shumë i rëndësishëm pasi që liron rrugën 'Dardania' dhe rrugën kryesore 'Prishtinë/Fushë-Kosovë', e cila krijon kolona të gjata në mëngjes, ka qenë premtim nga zyrtarët shtetërorë ku është thënë se rruga do të kushtoj 2.1 milion euro, dhe ka filluar procesi i shpronësimit, prandaj dua të dijë, a janë paraparë mjete financiare për këtë projekt dhe kur do të fillojë. Kërkesa nga bizneset dhe qytetarët, duke parë rastin e lirimit të hapësirave publike, unë kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës, që të punoj me 'Rregulloren e shfrytëzimit të hapësirave publike', gjithmonë duke respektuar planet rregulluese të Drejtorisë së Urbanizmit, me këtë rregullore do të caktoheshin, zonat dhe në bazë të zonave do të caktoheshin tarifatat, disa kërkesa nga bizneset të cilat janë dëmtuar nga heqja e terrasave, të bëhen shfrytëzim sezonal, vetëm me karrike dhe tavolina, gjithmonë duke respektuar vendimet e komunës, rregulloren e hapësirave publike dhe të paguajnë një tarifë, pastaj kemi vendosjen e reklamave, që mendoj që në bazë të rregullores duhet të paguajnë për m2, pastaj vendosja e kioskave sezonale ku me këtë rregullore do të rregulloheshin. Për biznese është vendosja e objekteve fizike, që mendoj që duhet t'i shohim si partner që të kenë mundësi ta kenë një vendparkim me pagesë, që mund të shenjëzohet me një ngjyrë. Investimet në infrastrukturë, kërkesa nga qytetarët rruga 'Hysen Xhakolli', pasi që janë përfunduar objektet banesore, në këtë pjesë kërkojnë që të asfaltohet kjo rrugë pasi që nuk është gjerësi e madhe, asfaltimi i një pjese në rrugën 'Tahir Zemaj', që është shumë e nevojshme, në rrugën 'Fehmi Lladrovci', mungesa e kanalizimit dhe kërkesa për asfaltim të rrugës, problemet me kanalizim në rrugën 'Nënë Tereza' përkatësisht nga 'Bau Market' deri te rreth-rrotullimi, sa i përket mirëmbajtjes së hapësirave publike, me datën 5 shkurt kam njoftuar Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedis, për disa mbetje inerte që janë pranë kontejnerëve, për korrektësi këtu është ndërhyrë, vetëm në rrugën 'Shefki Kuleta', ndërsa gjendja e keqe është në rrugën 'Dardania', objekti i Tregtisë Nr. 5, që është brenda oborrit, është gjendje shumë e rëndë. Në rrugën 'Besa Besë' janë dy pika në të cilat duhet të ndërhyhet, në rrugën 'Arbëria' është gjendja shumë e keqe, rruga 'Kuvendi i Lezhës' është gjendja shumë e keqe, prandaj përpos ndërhyrjeve ne si Kuvend i Komunës, të vendosim gjoba dhe të shikojmë ndonjë lokacion, se ku qytetarët mund të vendosin këto mbetje inerte, që përpara gjobave qytetarët të kenë mundësi të vendosin këto mbetje inerte. Kërkesë nga qytetarët e lagjes 'Kolonia' respektivisht rruga 'Drenica', ku kërkojnë të dinë nga Kryetari i Komunës, se a do të investohet në këto objekte që janë të vjetra, sepse gjendja

në pjesën e çatisë dhe izolimit është tepër e rëndë. Kërkesë tjetër është që nëpër vendstacione të vendosen kabina për shkak të reshjeve të shiut dhe ngricave.

Radoman Doderovic: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kanë filluar disa media të shkruajnë se unë jam në kualicion me Lëvizjen Vetëvendosje, dua të theksoi, se nuk jam në kualicion me askënd, të vetmin kualicion që e kam është me Bashkësinë serbe dhe malazezët, të cilët me kanë dhënë votën për përfaqësim, ne jemi përfaqësues komunal dhe do të merremi me çështjet lokale të Bashkësisë tonë, me rrugët, vërshimet, punësimin dhe kjo duhet të jetë prioritet për krejtë Asambleistët e Komunës së Fushë-Kosovës. Theksoi prapë që nuk jam në kualicion me askënd, i përshëndes të gjithë dhe ju uroj punë të mbarë.

Aida Alimi: Faleminderit Kryesues, të nderuar Kryetar, Nënkryetar i Komunës, kolegë asambleistë, media dhe të gjithë ju të pranishëm, për herë të fundit po e bëjë këtë pyetje kur do të jenë funksional mikrofonët? Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, kjo pyetje është për Kryesuesin e Kuvendit, a do të përfshihen këtu edhe personat me aftësi të kufizuara, apo do të ketë Komitet të vecantë, duke marrë parasysh nga përvoja kemi pasur Komitet për persona me aftësi të kufizuara', kësaj here nuk kemi, a do të përfshihen në këtë komitet kjo kategori e personave dhe kërkojë që rregulloret të vijnë në muajin mars, sic jemi dakorduar edhe me planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Vjosa Kida Hyseni: I nderuar Kryesues shumica e pyetjeve veç u thanë, një pyetje e kam për Drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në lidhje me takimin që është mbajtur me fermerë, pse nuk janë përfshirë gratë fermere? Pyetja e dytë ka qenë për Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban, i cili nuk është prezent, e ka marrë një shprehje me i larguar njerëzit për jashta, tani Kryetar nuk e di, a të ka ardhur një shqetësim nga ana ime, unë përfaqësoj qytetarët kam shkuar për një informacion në urbanizëm, dera ka qenë e hapur dhe kam rastisur me u takuar me drejtorin, i cili më ka thënë dil jashtë, për mua je një palë e thjeshtë dhe nuk është njerëzore një sjellje e tillë, unë kam qenë Drejtoreshë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, këtu dhe kam pas mirësjellje, nëse është më e rëndësishme për drejtorin me hudhë mbeturina vetë, sesa me pritë një palë, është e ulët për mendimin tim.

Kryetari i Komunës: Në cilën ditë keni qenë, sepse ai e ka ditën e caktuar kur pret palë.

Vjosa Kida Hyseni: Mundem me gjetë saktë ditën, më tha qysh keni hyrë në zyre, i thashë hina se dera ishte e hapur.

Kryetari i Komunës: S'mundet me qenë dera e hapur, sepse e vetmja derë e mbyllur është e urbanizmit në ditë të caktuara.

Vjosa Kida Hyseni: Dera ka qenë e hapur dhe kanë qenë tu nejt, një pyetje ja kam drejtuar një zyrtar më ka thënë dil jashtë jeni palë e thjeshtë, unë nuk jam palë e thjeshtë sepse përfaqësoj qytetarët. Sjellja është jo njerëzore.

Kryetari i Komunës: Nëse jemi këtu si asambleistë, nuk domethënë që e kemi mundësinë me bërë çka të dojmë.

Vjosa Kida Hyseni: Kryetar nëse ju e keni ndaluar me hyrë zyrtarët në parking, pse gjithmonë është parku këtu gruaja e tij, që është zyrtare dhe në rrugën 'Dardania', është një rrugë një kahëshe dhe Drejtori juaj hin në rrugë njëkahëshe, duke folur në telefon dhe unë me familje, duhet me u shtyer nga rruga për me zënë Drejtorin e Planifikimit Urban. Ju lutem mbi të gjitha është njerzillëku.

Kryetari i Komunës: Nëse drejtori e ka bërë atë shkelje është çështje e policisë.

Vjosa Kida Hyseni: Ai ka bërë shkelje dhe po sillet në mënyrë jo njerëzore, po më vjen keq, por drejtori paraparak ka pasur sjellje me njerëzore.

Kryetari i Komunës: Gjithmonë ka qenë e rregulluar puna me palë në urbanizëm, nuk e kemi sjellë ne.

Vjosa Kida Hyseni: Në të kaluarën kanë dalë drejtorët në koridor për palë, z. Vlonjati e ka marrë shqetësimin tim shumë më mirë se ju.

Kryetari i Komunës: Në të kaluarën edhe vendimet i kanë sjellë të gatshme vetëm me i nënshkruar, Zyrtarja Ligjore e Komunës, nuk e dinë çfarë vendime janë marrë në komunë. Çka kanë bërë të kaluarën, mos ma merr si pikë reference.

Vjosa Kida Hyseni: Është në shërbim të qytetarëve i nderuar, është dashur të më kthehet një përgjigje të paktën nga zyrtarët, jo prej drejtorit, është për keqardhje sjellje e tillë. Po më vjen mirë, që ju dështoni në këtë rast. Drejtorët e tjerë më kanë pritur mirë, unë përfaqësoj qytetarët dhe vijë për ta, jo për pyetje personale, ju kisha lutur më bërë një takim me fermeret gra, sepse kanë rol të rëndësishëm në sektorin e bujqësisë.

Kryetari i Komunës: Ty po të vjen mirë, nëse ne dalim keq, kjo s'po më pëlqen.

Vjosa Kida Hyseni: Kryetar një drejtor, me qitë jashtë palën, nuk është në rregullë.

Ali Ismaili: I nderuar Kryetar, Nënkryetar dhe Kryesues në tre muajt e parë, nuk ja vlen me ju bërë pyetje, sepse jeni rishtas në pushtet, unë e di për aq sa jam në institucione prej vitit 2006, se zyrtarët e komunës, punojnë dhe janë përgjegjës të Drejtorit të Administratës dhe një asamblesitë bazuar në ligjin Nr. 06/L-018 për qasje në dokumente publike, e parashtron një kërkesë me shkrim, duhet me marrë një përgjigje nga drejtori dhe unë i kam parashtruar tri shkresa me datë 19.01.2026, dy i kam marrë, një po pres me marrë deri nesër, është afati i fundit, Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, po besoj se ma kthen përgjigjen sikur këta me shkrim. Në të kaluarën Kryesuesi i tanishëm z. Vlonjat Hasani, kur i bëntë këto kërkesa me shkrim, nuk ja jepshin qasjen në dokumente publike dhe u ankojshin në vendin adekuat dhe ka pasur dënime për Kryetarin e Komunës, deri në vlerë financiare prej: 50,000.00 euro dhe unë po ju sygjeroi, i nderuari Kryetar që drejtorët e juaj të na japin qasje në dokumente zyrtare, kur i kërkojmë me shkrim. Drejtori i Administratës thotë kur i'a kam kërkuar 'Listën e Projektit të Karitasit', se jam adresuar gabim dhe thotë: se duhet me pas një zyrtar për qasje në dokumente zyrtare dhe ne nuk e kemi andaj sygjeroi që ju Kryetar t'i ta cakton një zyrtar për qasje në dokumente zyrtare, sepse asambleistët kanë të drejtë qasje në dokumente zyrtare, po shpresoi të merrni masa. Pyetja për z. Durim Hajra, është se i ka qitur disa shiritat dhe i ka ndalë disa punime, ditën e nesërme i kanë hjek shiritat dhe janë duke punuar, a jeni duke e bërë për reklamë këtë punë, për të na treguar si lloj kompoziteti, që po boni punë apo vërtetë jeni duke marrë masa me ndërprerë punimet.

Jetmir Berisha: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam disa pyetje dhe kam një pyetje që kam pesë vite që e bëjë rruga 'Bardh i Madh / Graboc i Poshtëm, është rruga më e shkatërruar, e dijmë të gjithë që është rrugë në kompetencat e Ministrisë së Infrastrukturës, kam bërë kërkesë edhe në mandatin e kaluar, së bashku me Drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis, por s'kemi marrë përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës, është rrugë shumë e frekuentuar dhe dëmet janë shumë të mëdha. Pyetja tjetër është ujësjellësi në Graboc i Poshtëm, janë duke punuar dhe deshta të dijë, për sa kohë do të lëshohet furnizimi me ujë të pijes në atë zonë? Pyetja e tretë është transporti i fëmijëve lagjes '14 Prilli', që është tani e disa vite në fshatin Graboc të Poshtëm, më herët ka qenë transporti nga Kompania që është kontraktuar nga Komuna, ku komuna jonë e

ka paguar prindërit për transportin, por do të doja që kjo formë të ndyshohet, sipas mundësive për arsye të ngarkesës së prindërve në puna. Pyetja e katërt një aksident që ka ndodhur në fshatin Graboc i Poshtëm mes trenit dhe një automjeti, aty është hap një rrugë me ide të banorëve dhe jemi drejtuar Hekurudhës që ajo rrugë të bllokohet, kërkoj dhe nga ju Kryetar i Komunës, që të ju drejtohet njerëzve kompetent, që rruga 'Berisha' të mbyllet. E kam obligim moral ndaj qytetarëve për rastin dje, që ka ndodhur para Komunës së Fushë-Kosovës, është rast jo i mirë për të cilin kam reaguar edhe me deklaratë publike, pasoja disiplinore do të merren për personin në fjalë, është akt individual i tij, janë lajmëruar organet kompetente dhe kërkoj, që të shkojë deri në fund ky rast. Sa i përket portaleve i bashkangjitem kolegut z. Migjen Kolshi, është e ulët dhe jo njerëzore dhe nuk i takon një njeriu normal, me ju drejtuar një menaxheri me akuzë, pas gjysem ore që është i porositur nga menxheri për të ndodhur ky rast. Fushë-Kosova e njeh kontributin e Jetmirit dhe punën e tij, nuk është në formë që të sulmohet një figurë në atë mënyrë, nuk po kam mundësi të ballafaqohem direkt, kush ka diçka mundet me fol përpara meje, por përpara nuk po më thotë askush, po e shfrytëzojnë rastin në portale. Jam i pastër dhe i ndershëm si pika e lotit. Respekt.

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë, kam pyetje më tepër si një formë sugjerimi për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, duke pasur parasysh intervenimet që janë bërë në kohën e vërshimeve, sigurisht aty ka pasur një Shtab Emergjent por tani e tutje në rrethana normale, vazhdohet me menagjim nga kjo drejtori, jam mirënjohës sa i përket intervenimit me kohë, sugjerimi është të funksionohet ky intervenim që vjen nga ju, kërkoj nga ju që të kemi një pasqyrë kadastrale, sa i përket përrockës 'Zanoga', ku ka uzurpime, ndërtime objektesh dhe në kohën e vërshimeve, ka pasur telashe nga kjo përrockë, është mirë që të bëhet një zgjidhje, të pastrohet përrocka.

Kryetari i Komunës: Ishin disa pyetje për portale, unë nuk menaxhoi portale, unë mund të flas vetëm për facebookun tim dhe faqen zyrtare të komunës, portalet e kanë punën tyre si për mirë, si për keq, jemi në demokraci. Drejtohuni në vendin adekuat nëse keni ankesa, por jo te unë.

Migjen Kolshi: Unë e kuptoj punën e portaleve që të bëjnë reklama e cka do qoftë, mirëpo nuk lejoj të më degradojnë, do të merren edhe me organet kompetente për këtë çështje. Është aktiviteti i Lëvizjes Vetëvendosje, për atë arsye po ju drejtohem juve që t'i ndalni dhe nëse nuk ndalen këta persona do të kemi probleme serioze.

Aida Alimi: Deshta të bëj dhe një pyetje kur do të kemi karta të identitetit dhe emailat zyrtare funksionale?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Me qenë se nuk ka tjera pyetje, po vazhdojmë me përgjigje, u përmend rruga 'Lumi', e kemi shikuar së bashku me drejtorët dhe shumë shpejtë do ta trajtojmë, z. Laureati dhe z. Migjeni folën për organizmin e mbledhjes solemne ju i përmendët disa veprime, por nuk jeni shumë korrekt, ne jemi konsultuar dhe nuk e përmendët, e dyta ka qenë mbledhje solemne dhe kemi dashur ta bëjmë në atë formë më të përbashkuar, me musafirë tjerë, sepse tingëllojshim keq për arsye të aktivitetit dhe brenda mbledhjes dhe paragjykimin për musafirët aty unë nuk u'a pranoj, sepse kanë qenë musafirë të nderuar të komunës tonë. Pyetja tjetër për mikrofonët e sallës së Kuvendit, kemi filluar me procedurën e hapjes në prokurorim për rregullimin e mikrofonëve dhe shumë shpejtë, do të rrisim sallën dhe do të përmirësojmë kushtet. Pyetja të Komiteti për persona më aftësi të kufizuar, hyn tek shëndetësia dhe mirëqenia sociale, edhe karta e identitetit do të flas me administratën, që t'i bëjë, sepse është e drejtë e asambleistëve dhe përgjigje në pyetjen e Dardanës, është 'Turbo Channel' është duke bërë incizimin, nuk kemi marrëveshje

me ta, s'kanë bërë aplikim, s'kanë marrë ndonjë pagesë, mbledhjet janë të hapura për publikun dhe nëse mendoni se duhet të mbyllen bëjeni propozimin dhe e qesim ne votim në Kuvend, tani komuna nuk ka marrëveshje me asnjë medium.

Nënkryetari i Komunës: Falënderit Kryesues, të nderuar të pranishëm dua të përgjigjem në disa pyetje, z. Laureat Gojnovci drunjë ka është kontrata kornizë, moti është përmirësuar dhe në të gjitha shkollat nuk po ka nevojë të ndizet zjarri, drunjët janë shpërndarë për arsye të një situatë emergjente, që ka qenë dhe kush ka pasur nevojë ka marrë drunjë. Çështja e bonuseve njëherë është anuluar, pastaj është plotësuar-ndryshuar, vendimi i anulimit dhe është shfuqizuar, është vendim që e ka marrë vetë Kryetari paraprak dhe nuk ka shkuar as në Ministri, e kemi dërguar në hetuesi dhe presim vendim prej gjykatës. I nderuar z. Ismaili heqja e shiritave kur t'i vendos Inspektoriat është vepër penale dhe Inspektorët është duke u marrë me këtë çështje. Sa i përket pyetjes së znj. Dardane, nuk kanë kona, është shpenzuar kontrata për rrënim, kemi mungesë të mjeteve financiare, probleme logjistike dhe do të presim deri sa të bëhet kontrata e re dhe pajtohemi me ju z. Murseli që thotë se duhet me pasur 'Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave publike' dhe jemi duke punuar në atë drejtim. Çështja që e ngriti z. Migjeni dhe z. Ismaili, nuk kemi të drejtë të ju japim lista të punëtorëve të organizatave dhe kompanive tjera private, punëtorët i marrin ata me rekrutim dhe ne kemi një kontratë me ta, ne përmes menaxherit ju kërkojmë këtyre operatorëve shërbime dhe i ofrojnë përmes punonjësve të tyre, shumica e punëtorëve janë ata që kanë qenë më heret. Tani z. Jetmir rruga Graboc i Poshtëm-Sllatinë e Madhe, është ashtu qysh e the nuk është kompetencë e jona, por kemi filluar komunikimin me Ministrinë dhe jemi duke u marrë me këtë çështje, po ashtu edhe ujësjellësi nuk kam informacion të saktë se kur mundet me përfunduar projekti. Unë z. Migjen nuk e di sa është saktë numri i punëtorëve me 'Kosova Med', por mund të pyes nëse mundem më ta dhënë, por një gjë z. Migjen ma herët kanë kushtuar më shumë fatura, e tani është rritur numri i punëtorëve dhe fatura po kushton më pak. Ju sqaroi juve z. Ismaili se do ta bëjmë një zyrtar për qasje në dokumente zyrtare dhe personalisht, do të angazhohem që cdo asambleistë të ketë qasje në dokumente zyrtare.

Laureat Gojnovci: I uroj kolegës mandatin, të priftë e mbara. Kryetari e liron sallën dy minuta para se të fillojnë përgjigjet dhe Nënkryetari përgjigjet që nuk i ka gjysmën e pyetjeve, sepse nuk ishte në sallë, unë këtë nuk e kuptoj, nuk mujta me marrë përgjigje për tunelin në Lismir, drunjët në shkolla e di që ka qenë gjendje e rënduar me vërshime, por drunjët nuk e determinojnë, a pshtojnë, a nuk pshtojnë, keni bërë shkelje që drunjët e shkollave, i keni dërguar në familje dhe po i leni fëmijet pa drunjë, drunjët janë shpërndarë në bazë të preferencave politike. Nuk mora përgjigje për përqindjen e grave në drejtori dhe Nënkryetar një përgjigje që e dhe, lidhur me puntorët e projekteve, që nuk guxon me dhanë emra, unë e konsideroj gabim, sepse ne si pushtet i kaluar kemi marrë dënim nga Kryesuesi i tanishëm i Kuvendit z. Vlonjat Hasani, pse nuk e kanë lejuar qasje në dokumente zyrtare të Projektit të Karitasit. Kryetari po e liron sallën dhe nuk po ballafaqohet me mua, herën e kaluar me akuzoi për hudhjen e dheut në fshatin tim dhe incizimin që është bërë, që e kam parë ka pasur pjesë të shkëputura dhe duhet vetë unë ta incizoj ballafaqimin, e pastaj qytetarët të vlerësojnë kush ka pasur të drejtë.

Nënkryetari i Komunës: E para z. Laureat, ty nuk ta ka ndaluar askush me incizuar, gjatë kohës që jeni këtu, e dyta Kryetari në mbledhjen e kaluar ka nejt deri në fund, por ka një angazhim i cili po i'a pamundëson me qëndruar këtu tërë kohën, është risi Kryetari më qëndruar këtu. Nuk di që ka pasur dikush nevojë për drunjë dhe nuk i kanë shkuar, më herët kur kemi pasur me diskutuar

një raport të shpenzimit zyrtar për drunjët, ka dalë që krejt drejtoritë kanë shpenzuar drunjë, bile edhe Kuvendi i Komunës, ndërsa ne ju kemi jep drunjë atyre që kanë pasur nevojë.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përhëndetje Kryesues, kryetar dhe ju të gjithë asambleistë, pyetja që më janë drejtuar për murin e dëmtuar të Hekurudha, dua të ju njoftoj që atë muri e kanë dëmtuar banorët dhe me arsye, sepse ne kemi qenë aty atë natë dhe i'a ka hyrë uji banorëve dhe ata e kanë dëmtuar diku një m², tani janë të dëmtuara rreth 5 ose 6m², e kanë dëmtuar vetë banorët dhe këtë çështje është duke e trajtuar Policia e Kosovës, ne do ta rregullojmë edhe pse është e Hekurudhës. Sa i përket anëtarit të Bordit, ju e dini se deri tani anëtari i Bordit ka qenë z. Valon Bogiqi, i cili ka dhënë dorëheqje pa paralajmërim dhe i ka vazhduar kontrata Drejtorit të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', me performancë që është jashtë ligjore, nuk na ka njoftuar për asnjë vendim, që e ka marrë. Ai ka dhënë dorëheqje pa paralajmërim dhe ne si Komision i Aksionarëve, është dashur menjëherë që mos ta lëmë pa përfaqësim, e kemi emëruar zonjën në fjalë, ligji nuk është shkelur, sepse është e përkohëshme. Ne jemi për të mbrojtur qytetarët e Fushë-Kosovës, gjendja me mbeturina, nuk është aspak e mirë, po shpresojmë se do ta rregullojmë në të ardhmen. Në fshatin Henc, kemi qenë së bashku me tjerë drejtor dhe kemi parë, se është shkelur një pjesë, tani jemi në rishikim nga Kadastri dhe janë ndërtuar objekte dhe kur të rregullohet koha, ne do të pastrojmë përrockën 'Zanoga'. Për mbeturina të vëllimshme ne jemi duke i mbledhur, aq sa po kemi kapacitet, deponia nuk i ka pranuar të vëllimshmet u dashur të grimcohen në menyre, që t'i dergojmë, sa i përket ndriqimit në fshatin Sllatinë e Vogël dhe të Pishat kemi kontratë dhe do e rregullojmë.

Drejtori për Infrastrukturë: Përhëndetje për të gjithë, unë dua të përgjigjem në pyetjet, që më janë drejtuar, njëra ishte për gropa në Komunën e Fushë-Kosovës, është kogja sfiduese puna e gropave, e kemi një kontratë të trashëguar nga pushteti i kaluar, e cila i ka të shpenzuara sasinë e gropave që duhet të mbyllen, sipas inoformatave gjatë kohës së fushatës për të mbuluar, jo vetëm gropa por edhe sipërfaqe, jemi duke bërë amandamentimin e kontratës dhe besoi që do t'i rregullojmë gropat. Pyetja tjetër sa i përket rrugës 'Doruntina', është në kuadër të Ministrisë dhe po pritet të bëhet shpronësimi, që të vazhdohet tutje. Sa i përket segmentit Sllatinë-Bardh-Graboc, para dhjetë ditëve kemi dërguar shkresë zyrtare Ministrisë së Infrastrukturës, për të intervenuar në këtë rrugë.

Drejtori për Arsim: Përhëndetje për të gjithë, kur e vlerësojmë që jemi në një gjendje emergjente, krejt resurset që i kemi vendos në shërbim të qytetarëve, e ne jeta ka qenë puna edhe me drunjët, kur merr deklaratë si formë konstatimi dhe do pastaj më shitur si formë absolute, nuk është në rregull, sepse të gjitha shkollat kanë drunjë, e kur nuk paskeni drunjë, sipas jush tregoni dhe do të ju përgjigjem.

Laureat Gojnovci: Drejtor në asnjë moment, nuk thashë që nuk ka drunjë dhe konstatimi, që t'i e the për mua nuk qëndron, unë thashë, nëse vazhdon moti i keq shkollat do të mbeten pa drunjë, t'i kisha treguar me emër shkollat, por jeni duke bërë presion siç keni bërë te drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, menaxheri i Kompanisë 'Pastrimi', me inskenime të ulta.

Drejtori i Arsimit: Nxitjen e pata të ajo fraza, ku thatë po i leni fëmijët pa drunjë, për arsye se është e pavërtetë, sa i përket presionit për drejtor, po flas për arsim i vetmi presion që mundet me u dukur është serioziteti dhe profesionalizimi im, për presion tjetër le të lajmërohen në çdo insitucion, unë jam i hapur. Unë kam interes që shkollat të funksionojnë mirë, ambientet të jenë

të ngrohta dhe procesi me qenë dinjitoz. Nuk ka këshilltare të arsimit, të cilët i vizitojnë shkollat pa lejen time.

Valon Murseli: A janë ndarë mjete buxhetore për rrugën 'Fehmi Lladrovci' në Fushë-Kosovë?

Migjen Kolshi: Kryetari që dy mbledje nuk më është përgjigjur në pyetjet e mia.

Drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Përshëndetje për të gjithë, unë një pyetje e pata nga znj. Vjosa Kida Hyseni, deshta ta njoftoj që po një takim është mbajtur, thirrja ka qenë e hapur, një pjesë e madhe e fermerëve janë komunikuar edhe me telefon, sa i përket pjesës së grave fermere, unë po them që ka pasur edhe gra fermere, arsyeja që nuk është mbajtur në sallën e Kuvendit, ka qenë sepse kam besuar që do të ketë numër të madh të pjesëmarrësve dhe salla nuk ka kapacitet të madh. Kjo është sa i përket pyetjes tuaj.

Valon Murseli: Pika e diskutimit në mbledhje me fermerë ka qenë, si do të vazhdohet forma e subvencionimit dhe granteve, e di që është kohë e shkurtë edhe për drejtorin, por disa komuna i mbështesin me subvencionim të fidaneve, nuk e di nëse Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e ka këtë model dhe cila ka qenë kërkesat, cila është mundësia e komunës me i mbështet bujqit, sepse unë kam parë në të kaluarën, janë shpërndarë moto-kultivatorët dhe mendoj që nuk është formë e duhur e mbështetjes së fermerëve, ka mjete tjera për bujqësi, që mund të përdoren nga fermerët.

Drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Faleminderit asambleist i nderuar, edhe unë po të garantoj që pjesa e serrave, moto-kultivatorëve ka përfunduar, sa i përket pjesës së cka duhet me dhënë, ne kemi një buxhet të trashëguar, për këtë arsye kemi mbajtur takimin, kërkesat kanë qenë të mëdha në krahasim me buxhetin që kemi, por do mundohemi të jemi sa më afër kërkesave tyre.

Drejtori për Planifikim Urban: Përshëndetje për të gjithë, qasja në urbanizëm është e lehtë, e ka një orar që respektohet dhe kryeni punë, i vetmi asambleist që ka qenë në urbanizëm ka qenë z. Habib Mekolli, të vetmin asambleist që kam kontaktuar personalisht ka qenë z. Ali Topalli, tjerët që jeni të interesuar me ardhur në Drejtorinë e Planifikimit Urban është e-maili zyrtar, është telefoni për ndryshe është orari të martën dhe të enjtën, po i'u tregoj publikisht që duhet të respektohet.

Ali Ismaili: Është qasje e gabuar nga ana e juaj drejtor në këtë shekull, sepse ne jemi asambleistë dhe kemi të drejtë të parashtrijmë kërkesa.

Drejtori për Planifikim Urban: Po pajtohem me mendimin tend, por drejtor jam unë, pyetjet i bëni dhe kërkesat, unë përgjigjem.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Specifikat i ka secila drejtori, ato dyer kanë qenë gjithmonë të mbyllura për asambleistë këtë e dimë të gjithë, nëse Drejtoria e Planifikimit Urban, e sheh të arsyeshme këtë formë të funksionimit i ka arsyet e veta.

Drejtori për Planifikim Urban: Është e drejtë në secilën komunë nuk mundesh me hyrë në Drejtorinë e Planifikimit Urban në çfarë do kohë, për arsye se ka lëndë që duhet të procesohen, nuk ka dokumente dhe projekte që përgaditen brenda ditës, nëse doni të vini bëni kërkesë dhe unë ju përgjigjem, unë nuk e kam personale me askënd.

Ali Topalli: Unë dola sa për sqarim z. Taulant, ju më keni kontaktuar në një ditë të marte, nëse nuk gabohem dhe keni kërkuar një takim me mua dhe me Drejtorin e Kulturës, ditën që ju e keni caktuar ka qenë për të enjtën, e dyta kemi biseduar përmes telefonit ju kam konfirmuar, që do të vijë në takim dhe ju keni thënë se nesër ditë e mërkure, unë do të ju kontaktoj me u marrë vesh për orën, ju nuk më keni kontaktuar.

Koha e pushimit në kohëzgjatje prej një ore.

Pika e katërt (4) - Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë’, ftoj Drejtoreshën për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që të na paraqet përmbajtjen e materialit.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Falënderit Kryesues, më lejoni që para jush të paraqes ‘Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, tani Kuvendi i Komunës së Fushë-kosovës, bazuar në nenin 12, pika 2, shkronja d, nenin 17 shkronja b, c, d, s, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me Nr. 03/L-040, nenin 12.1 shkronja b, c, ç, neni 13, shkronja ç, të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 98, të datës 12.08.2012, i propozon Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, që të shqyrtojnë propozimin dhe të marrë vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, në bashkfinancim me Ministrinë e Shëndetësisë sipas Marrëveshjes së nënshkruar 23.12.2025, ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë në ngastrat kadastrale, materialin të cilin e keni pranuar paraprakisht, propozimit i bashkangjitet edhe dokumentacioni përcjellës për pronat komunale, andaj ju lutem ta votoni këtë propozim.

Kosovar Ademi: Falënderit Kryesues, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, është hap i rëndësishëm i infrastrukturës shëndetësore në komunën tonë dhe për përmirësimin e shërbimeve mjekësore dhe rritjen e kapaciteteve të tyre, ky projekt është në bashkëfinancim me Ministrinë e Shëndetësisë sipas Marrëveshjes së nënshkruar më datë 23.12.2025 dhe është shembull i mirë i bashkëpunimit mes nivelit qendror dhe lokal, ne si subjekt e mbështesim këtë propozim dhe ju sugjerojmë edhe subjekteve tjera ta mbështesin.

Laureat Gojnovci: Falënderit Kryesues, sa i përket propozimit për caktimin e lokacionit të ndërtimit të objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’, në Fushë-Kosovë, parimisht jemi pro që komuna jonë, duhet të ketë një qendër më të mirë të mjekësisë familjare, sa i përket ofrimit të shërbimeve mjekësore, tani Drejtoreshë në mandatin e kaluar ne si legjislacion e kemi marrë vendim që këtë ngastër kadastrale ta ndajmë për ndërtimin e Xhamisë, edhe Grupi i asambleistëve të Lëvizjes Vetëvendosje e patën kundërshtuar fuqishëm, duke u thirrur që nuk është e inkuorporuar në Hartë Zonale të Komunës, në Planin Zhvillimor Komunal, e kemi pas inkuorporuar por masi është shfuqizuar Plani Zhvillimor Komunal, i bjen që nuk është në atë Plan. Drejtoreshë dashta me bërë edhe një pyetje, se a është nënshkruar Marrëveshja e ndërtimit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, me Ministrinë e Shëndetësisë.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Po, është nënshkruar.

Laureat Gojnovci: Qysh është nënshkruar pa u caktuar lokacioni prej Kuvendit të Komunës, njëherë duhet të caktohet lokacioni pastaj fillojnë procedura tjera. Kjo çështje i takon Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe do doja të kisha mendimin e drejtorit se çka parashihet të ndërtohet aty. Ngastrat Kadastrale që i keni bërë bashkë, a janë të mjaftueshme për ndërtimin e objektit

shëndetësorë, për arsye se Ministria e Shëndetësisë, sa ishim ne në pushtet e patë zvogëluar projektin, dimensionet e ngastrave kadastrale janë problematike, nuk është ngastër e përshtatshme për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, ne nuk e përkrahim jo për arsye politike, por vetëm me i respektuar dokumentet mbi të cilat funksionon Komuna e Fushë-Kosovës.

Migjen Kolshi: Faleminderit Kryesues, sa i përket caktimit të lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë jemi për, por mendojmë se nuk janë respektuar procedurat, sepse ajo ngastër kadastrale siç e tha edhe kolegu z. Laureat Gojnovci është planifikuar për Xhami.

Ali Ismaili: Faleminderit Kryesues, te kjo pikë materiali ka qenë i zymtë dhe sot mungon plani i auditimit, së dyti për Drejtorin e Kadastrit dhe Gjeodezisë, në fletat poseduese, që na i keni sjellë, këtu janë fleta poseduese, aty është Rruga e Pejës, ndërsa këtu shkruan Rruga ‘Tahir Zemaj’, është diçka teknike, që ka ngelë dhe disa shkolla fillore, i kemi ende me emërtime serbe. Po mendoj se, vendimi që e kemi marrë për Xhami, nuk përputhet me këtë propozim është më poshtë, është ngastër kadastrale krejt tjetër. Unë e mbështes propozimin e Drejtoreshës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëse janë respektuar procedurat, sepse është e domosdoshme.

Ali Topalli: Drejtoreshë sinqerisht unë kam pritur që këtij propozimi t’i bashkangjitet edhe një lloj arsyeshmërie, e kam fjalën se pse duhet të ndërtohet një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare, e re dhe çka do të bëhet me objektin ekzistues?

Etnik Berjani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, është një nga projektet më të rëndësishme të komunës tone, prandaj konsideroj që çdo vendim lidhur me caktimin e lokacionit, duhet të jetë i bazuar në analiza profesionale, planifikim afatgjatë dhe transparencë të plotë ndaj qytetarëve. Që ky projekt të ketë sukses dhe të mos krijohen pengesa në të ardhmen, kërkoj disa sqarime lidhur me procesin e përzgjedhjes së lokacionit, për bazën e vendimit cilat kanë qenë kriteret profesionale dhe teknike, mbi të cilat është përzgjedhur ky lokacion për objektin shëndetësorë. Për qasjen dhe funksionalitetin, a është bërë analizë e qasjes ambulance, parking dhe qarkullimi i qytetarëve në këtë zonë dhe për alternativa, a janë shqyrtuar lokacione tjera dhe pse është marrë ky lokacion.

Vildane Latifi: Duke marrë parasysh që kemi një komunë të mbingarkuar, kjo kërkesë që vjen nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, është shumë e arsyeshme, sepse popullësia është rritur dhe stafi ekzistues, nuk po mundet me i ballafaquar punët që duhet të kryen.

Driton Ademi: Nisma Socialdemokrate, i jep përkrahje ndërtimit të objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, pasi që në komunën tonë është rritur numri i banorëve, sa i përket çështjes së lokacionit duhet të konsulltohen Drejtoria e Planifikimit Urban për dokumente strategjike, për ndryshe kemi shumë nevojë për këtë objekt shëndetësorë dhe ne e mbështesim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë dua të jap një qëndrim personal për këtë punë, kur thatë që ka thanë Ministria e Shëndetësisë me zvogëluar projektin, nevoja për ndërtimin e një Qendre Kryesore të Mjekësisë Familjare, unë në plotëni edhe më të madhe besoj, se të gjithë jemi të pajtimit, se është e domosdoshme për arsye të rritjes së numrit të banorëve, kërkesa që është bërë në të kaluarën e që ka ardhur nga Ministria, që duhet të zvogëlohet projekti, ka ardhur sepse nuk ka qenë kjo hapësirë e paraqitur për ndërtimin e objektit shëndetësorë, lokacioni ka qenë më i vogël dhe Ministria ka thanë bëjë më të vogël, sepse po del jashtë kufijëve kadastral, meqenëse ne e kemi

propozuar pjesën më të madhe të ndërtimit, nuk ka ndonjë problem. Objekti shëndetësorë do të ndërtohet me kushtë shumë të mira, e ardhmja e shëndetësisë, do të përmirësohet dhe ju inkurajoj ta mbështesni të gjithë, sepse do të na shërbej të gjithëve. Në Hartën Zonale të Komunës, ky lokacion është paraparë si zonë e shërbimeve sociale dhe ne mundemi me e bërë ndërrim të destinimit, gjithë çka është brenda kornizave ligjore, andaj ju lutem si kolegë votone këtë propozim të ardhur nga Ekzekutivi i Komunës, për të ardhmen më të mirë për qytetarët tanë.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Duke pasur parasysh numrin e banorëve, që do të rritet edhe numri i shërbimeve brenda Qendrës tonë shëndetësore, sepse objekti i vjetër nuk ka hapësirë të mjaftueshme dhe nga kjo ka lindur ideja për ndërtimin e objektit të ri, sa i përket objektit të vjetër, do të shohim ku i kemi nevojat më të mëdha dhe do të ndërrohet destinimi.

Ali Ismaili: Sa është kostoja e këtij projekti që Kryetari i Komunës, e ka nënshkruar me Ministrinë e Shëndetësisë, kur thoni ka me pasur shërbime shtesë, është mirë të tregohen me letër, sepse kjo pikë e rendit të ditës nuk na vjen më në shqyrtim.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Projekti nuk është ideuar ende, janë 2.5 milion euro prej Ministrisë së Shëndetësisë dhe 1.5 milion euro prej komunës, do të shtohet në Qendrën shëndetësore edhe shërbimi i logopedit, i psikologut, i fizioterapeutit dhe sociologut.

Etnik Berjani: Prej rrugës gjerësia më e gjerë në këtë ngastër kadastrale është 30 metra, ku do më vendos kur është magjistralja me lëvizje të automjeteve të shpejta, si do të bëhet këtu një Qendër shëndetësore, me shërbime me të gjera, sepse ne jemi për ndërtimin e saj, por duhet të shikohet lokacioni me detaje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kur bashkohen tri ngastrat kadastrale, bëhet hapësirë e mjaftueshme.

Vildane Latifi: Më vije interesant që në Komunën e Fushë-Koosvës, kemi pasur vetëm dy qendra të Mjekësisë Familjare, njëra ka punuar 24 orë, tjetra me ndërrime. Në si asambleistë duhet t'i përkrahim këto nisma, që janë të domosdoshme për jetën e qytetarëve.

Laureat Gojnovci: Kam dy çështje, e para Kryesuesi i Kuvendit tha çka parashihet me Hartën Zonale të Komunës dhe shkrun aty shërbime sociale, është aty edhe një pjesë që atë se për mendi edhe shkruan institucioni shkollor, e dyta nuk e përkrahim për arsyet që i cekta më herët, unë dhe kolegu im z. Etnik Berjani, nuk është në hartën zonale, plan zhvillimor komunal nuk kemi, ju vazhdoni, por vetëm duke i respektuar dokumentet strategjike të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar koleg asambleistë kush është për aprovimin e 'Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës, në ngastrat kadastrale të propozuara.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi I Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi I Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës, në ngastrat kadastrale të propozuara' dhe mori:

V E N D I M

1. Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës në ngastrat kadastrale si vijon:

- 1.1 Ngastra Kadastrale Nr. P - 72514036- 01380-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, pronë e komunës në sipërfaqe prej: S = 2985 m²;
- 1.2 Ngastra Kadastrale Nr. P - 72514036- 01379-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, pronë e komunës në sipërfaqe prej: S = 1031 m² dhe
- 1.3 Ngastra kadastrale Nr. P - 72514036- 01378-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, pronë e komunës në sipërfaqe prej: S = 573 m².
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumentacioni i certifikatave të pronës, për secilën njësi kadastrale të datës 05.02.2026 dhe kopja e planit, për lokacionin e evidentuar në paragrafin një (1), nën-paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij vendimi.

Pika e pestë (5) - Propozimin për shpalljen e interesit publik për ngastrat kadastrale në zonën kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për shpalljen e interesit publik për ngastrat kadastrale në zonën kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës, unë dua të jap një sqarim shtesë, për këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit që ka ardhur prej Ekzekutivit të Komunës, ju e keni parë listën e ngastrave kadastrale të cilat janë paraqitur për t’i shpallur zona të interesit publik, për arsye se Ekzekutivit të Komunës, munden në të ardhmen me ju nevojitet këto zona për shërbime ndaj qytetarëve, na ka ardhur një propozim për një ndryshim të vogël, sepse tri ngastra janë në proces gjyqësor që gjenden në fshatin Miradi e Epërme dhe duhet me i larguar nga kjo listë, pikat e tjera mbesin si kanë ardhur. Hapi diskutimin.

Kosovar Ademi: Të nderuar kolegë deri tani ishin në diskutime për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe problematika ishte tek lokacioni, kjo ndërlidhet me këtë pikë dhe është pikë shumë e rëndësishme, sepse komuna jonë ka mungesë të hapësirave publike, këto prona mund të shfrytëzohen për projekte konkrete si çerdhe, shkolla, shërbime publike, sportive e tjera. Ky hap garanton që pronat komunale, të përdoren në mënyrë të përgjegjshme dhe efektive, ne si subjekt politikë e përkrahim këtë propozim dhe ju ftojmë ta përkrahni dhe ju.

Laureat Gojnovci: Falënderit Kryesues, dikush nga Ekzekutivi i Komunës duhet të na tregoj nevojën pse duhet të kaloj ky propozim, na duhet të ju referohemi Ligjit Nr. 03/L-139, për shpronësimin e pronës së paluajtshme, ku neni 8, pika 1.5, thotë se vetëm për qëllim publik duhet të shpronësohet një pronë, para se të shpronësohet duhet me pasur një projekt, këto janë prona të Agjensisë Kosovare të Privatizimit, jo të Fushë-Kosovës, bile duhet më pasur edhe buxhet të planifikuar. Nuk është e nevojshme të shpronësohen të gjitha këto ngastra kadastrale, përveç tri ngastrave kadastrale në Miradi të Epërme, edhe ngastra kadastrale Nr. 4444-0 në fshatin Sllatinë e Madhe është në proces gjyqësor. Ngastra Kadastrale Nr. 377-04 është pronë e Stadiumit, këtë e kemi votuar në 2022, si zonë me interes të veçantë, ky material ka shumë ngastra kadastrale dhe është e pamundur me i identifikuar të gjitha, unë mendoi se duhet të shtyhet kjo pikë dhe ekipa që e ka përpunuar këtë material t’i shikojnë këto ngastra kadastrale, edhe njëherë, sepse materiali nuk është i kompletuar, ne do t’i votojmë propozimet kur dokumentet të jenë në rregull dhe sqarimet në rregull.

Valon Murseli: Në parim e përkrahim, por mbi bazën ligjore, që është thirrë ky propozim më shumë flitet për pronat e komunës, se sa për pronat në menaxhim të Agjensisë Kosovare të Privatizimit, te neni 24, pika 5 thuhet, për realizimin e këmbimit të pronës, paraprakisht duhet të jenë të siguruar mjetet financiare për realizimin e projektit me interes publik, që në këtë rast

mendoj që ka materiale të mangëta jemi për, që të bëhet shkëmbimi i pronave për ndërtimin e institucioneve që janë në interes të qytetarëve të Fushë-Kosovës, sepse ka mungesë të pronave.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pronat janë prej shtetit si të komunës dhe të Agjensisë Kosovare e Privatizimit, kur shpronësohen përdoret kodi i njejtë, ne po i shpallim si zona të interesit publik, andaj vazhdojmë me procedura tjera.

Driton Ademi: Në bazë të Ligjit për pronën publike, unë e konsideroj shumë të rëndësishme një lloj të shpalljes së interesit publik, që ka të bëjë me vizionin e komunës, si do të duket në të ardhmen sa i përket shfrytëzimit të pronave publike. Komuna është e obliguar çdo vitë të publikoi listën e pronave ekzistuese dhe në bazë të Ligjit për pronë publike, jo vetëm prona komunale është pronë publike, por edhe prona shtetërore është pronë publike, që është në menaxhimin e Agjensisë Kosovare e Privatizimit dhe rregullohet me ligj të veçantë. Nëse Qeverisë i duhet një pronë e komunës për interes publik, komuna nuk mundet me kundërshtuar, por duhet me ju përgjegjë Qeverisë dhe anasjelltas. Ky lloj planifikimi paraparak, që lidhet me të ardhmen e komunës është shumë i rëndësishëm dhe Nisma Socialdemokrate e përkrah.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, ne po tentojmë t'i rrisim pronat e komunës, që të kemi mundësi të zhvillojmë komunën.

Rrahim Tërnavaj: A i keni kontrolluar mirë këto ngastra kadastrale, sepse nuk na keni dhënë sqarime, a janë në procedurë gjyqësore?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ato tri që janë në process gjyqësor i larguam, nuk ka problem edhe nëse prona është në kontest gjyqësor, komuna ka të drejtë me ligj me e shpallur zonë të interesit publik, edhe nëse gjendja e pronës nuk është e definuar, sepse pretë një vendim gjyqësor, kur tenton me u kthyer si pronë komunale, atëherë duhet me pritë vendimin e gjyqit. Ne vetëm po i shpallim zona të interesit publik, nuk jemi tu i marrë ende këto ngastra kadastrale, sepse ka edhe procedura tjera.

Laureat Gojnovci: Kryesues është një kontradiktë, sepse t'i veç sa i largove tri ngastra kadastrale, unë po them që është edhe një pronë në Sllatinë të Vogël, në gjykatë, a po doni me lanë pjesë të propozimit? Pjesën e Stadiumit e dini që e kemi shpallur zonë me interes të veçantë prapë është inkorporuar këtu, kjo të bën të dish, se ky dokument nuk ka analizë të thellë të këtyre ngastrave kadastrale, kjo është dëshmia pse ky vendim nuk duhet me kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo është dëshmia më e mira, sepse këtu po tentohet me ju rritë pasuria komunës tonë, çdo ngastrë kadastrale që ka ardhur këtu, është për arsye, se është në interes të përgjithshëm.

Ali Ismaili: I nderuar Kryesues kishte qenë mirë këtu me qenë Zyra Ligjore ose një përfaqësues ligjor për të na sqaruar këtë pjesë, unë e mbështes këtë propozim, duke besuar se ju i keni kontrolluar këtë listë, na parimisht i shpallim andaj duhet për secilën zone, me dërgur një kërkesë në Qeveri. Këtu Qeveria me bashkëbisedim me Agjensinë Kosovare të Privatizimit dhe me hyrë në negociata me komunën për pjesën e 20%, është mirë ne si Asamble Komunale të pajisemi me dokumente në përgjithësi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Ali Ismaili, mirë e kini që po kërkon dokumente për secilën ngastër kadastrale, do të mundohemi që secili nga ju të ketë të paktën fotografinë e pronave nga gjeoportali në email.

Etnik Bejani: Unë thashë qysh me votuar këtë pikë kur tri të parat i verifikuam dhe i larguam, unë në bazë të asaj po besoj që nuk janë verifikuar asnjë dhe kishte qenë mirë me shtyer si pikë dhe të verifikohen edhe njëherë pronat në fjalë.

Rrahim Tërnavaj: Nëse e shpallin zonë të interesit publik, nuk dome thënë që shpronësohet prona menjëherë, ky vendim nuk e pengon procesin gjyqësor dhe është vendim, që nuk ndikon në ndërrimin e pronës dhe pronarit, të kemi kujdes të mos ndikojmë me ndërruar kadastrin ose pronarin, me shpallur interes publik kemi drejtë, kështu që le të ecë ky propozim, përgjegjësia mbetet te drejtori dhe zyrtarët, nëse ka ndodhë ndonjë gabim në numrin e fletave poseduese të ngastrave kadastrale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë për sqarimin, unë e inkurajoj Ekzekutivin e Komunës, që çdo mbledhje me na sjellë prona për me i shpallur zonë të interesit public, sepse është në dobi të komunës tonë.

Driton Ademi: Mendoj që ky vendim duhet të ketë një shpallje publike, ku qytetarët mundën me ju adresuar këtyre ngastrave kadastrale, zakonisht te Agjensia Kosovare e Privatizimit kur ndodhë privatizimi lëndet të cilat janë në kontest, i qojnë në dhomën e posaçme e ajo merret me to, kështu që kadastrin le t'i identifikon, kërkesë ime është me pasur mundësi, me bërë shpallje publike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Momenti që merret vendimi shpallet publikisht. Kolegë e keni mundësinë me verifikuar edhe vetë secilën pronë në gjeo-portal, por meqenëse keni të drejtë me pasur materialin fizikisht, keni të drejtë me kërkuar fizikisht ose në email. Po e qesim në votim propozimin, pa ato tre pronat që i larguam në fshatin Miradi e Epërme

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi I Komunës me unanimitet të votive të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Propozimin për shpalljen e interesit publik për pronat nën menaxhimin e Agjensisë Kosovare të Privatizimit, në Zonat Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për shpalljen e interesit publik për pronat nën menaxhimin e Agjensisë Kosovare të Privatizimit, në Zonat Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës si vijon:
 - 1.1 Ngastra Kadastrale P - 72514027-00340-0 - Zona Kadastrale Miradi e Poshtme;
 - 1.2 Ngastra Kadastrale P - 72514027-00481-0 - Zona Kadastrale Miradi e Poshtme;
 - 1.3 Ngastra Kadastrale P - 72514027-00056-1 - Zona Kadastrale Miradi e Poshtme;
 - 1.4 Ngastra Kadastrale P - 72514027-00333-0 - Zona Kadastrale Miradi e Poshtme;
 - 1.5 Ngastra Kadastrale P - 72514027-00418-5 - Zona Kadastrale Miradi e Poshtme;
 - 1.6 Ngastra Kadastrale P - 72514027-00436-1 - Zona Kadastrale Miradi e Poshtme;
 - 1.7 Ngastra Kadastrale P - 72514027-00438-0 - Zona Kadastrale Miradi e Poshtme;
 - 1.8 Ngastra Kadastrale P - 72514027-00452-3 - Zona Kadastrale Miradi e Poshtme;
 - 1.9 Ngastra Kadastrale P - 72514031-00188-0 - Zona Kadastrale Henc;
 - 1.10 Ngastra Kadastrale P - 72514003-00020-0 - Zona Kadastrale Harilaç;
 - 1.11 Ngastra Kadastrale P - 72514003-00290-0 - Zona Kadastrale Harilaç;
 - 1.12 Ngastra Kadastrale P - 72514003-00021-0 - Zona Kadastrale Harilaç;
 - 1.13 Ngastra Kadastrale P - 72514057-00258-0 - Zona Kadastrale Pomozatin;
 - 1.14 Ngastra Kadastrale P - 72514057-00280-0 - Zona Kadastrale Pomozatin;
 - 1.15 Ngastra Kadastrale P - 72514022-00114-0 - Zona Kadastrale Lismir;

- 1.16 Ngastra Kadastrale P - 72514022-00346-0 - Zona Kadastrale Lismir;
- 1.17 Ngastra Kadastrale P - 72514038-00483-0 - Zona Kadastrale Kuzmin;
- 1.18 Ngastra Kadastrale P - 72514038-00545-0 - Zona Kadastrale Kuzmin;
- 1.19 Ngastra Kadastrale P - 72514038-00767-0 - Zona Kadastrale Kuzmin;
- 1.20 Ngastra Kadastrale P - 72514038-00794-0 - Zona Kadastrale Kuzmin;
- 1.21 Ngastra Kadastrale P - 72514038-00907-2 - Zona Kadastrale Kuzmin;
- 1.22 Ngastra Kadastrale P - 72514038-00916-0 - Zona Kadastrale Kuzmin;
- 1.23 Ngastra Kadastrale P - 72514028-00041-0 - Zona Kadastrale Grabovc i Poshtëm;
- 1.24 Ngastra Kadastrale P - 72514028-00092-0 - Zona Kadastrale Grabovc i Poshtëm;
- 1.25 Ngastra Kadastrale P - 72514010-01244-0 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.26 Ngastra Kadastrale P - 72514010-01247-0 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.27 Ngastra Kadastrale P - 72514010-01248-0 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.28 Ngastra Kadastrale P - 72514010-01249-0 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.29 Ngastra Kadastrale P - 72514010-01250-0 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.30 Ngastra Kadastrale P - 72514010-01251-0 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.31 Ngastra Kadastrale P - 72514010-01255-0 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.32 Ngastra Kadastrale P - 72514010-01310-0 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.33 Ngastra Kadastrale P - 72514010-01311-0 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.34 Ngastra Kadastrale P - 72514010-00606-1 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.35 Ngastra Kadastrale P - 72514010-00607-0 - Zona Kadastrale Bardh i Madh;
- 1.36 Ngastra Kadastrale P - 72514048-00004-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Vogël;
- 1.37 Ngastra Kadastrale P - 72514048-00010-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Vogël;
- 1.38 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00835-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.39 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00837-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.40 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00853-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.41 Ngastra Kadastrale P - 72514009-01012-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.42 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00476-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.43 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00248-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.44 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00249-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.45 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00226-2 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.46 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00226-4 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.47 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00226-7 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.48 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00226-8 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.49 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00135-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.50 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00139-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.51 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00140-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.52 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00150-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.53 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00152-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.54 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00216-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.55 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00225-2 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.56 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00225-4 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.57 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00225-5 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.58 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00225-6 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.59 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00226-7 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.60 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00226-8 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;
- 1.61 Ngastra Kadastrale P - 72514009-00265-0 - Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe;

- 1.154 Ngagra Kadastrale P - 72514036-00021-1 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.155 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01200-0 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.156 Ngagra Kadastrale P - 72514036-00394-0 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.157 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01082-1 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.158 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01082-3 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.159 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01082-4 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.160 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01082-7 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.161 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01082-8 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.162 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01082-10 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.163 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01082-11 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.164 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01082-12 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.165 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01082-13 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.166 Ngagra Kadastrale P - 72514036-01082-15 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.167 Ngagra Kadastrale P - 72514036-00410-67 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.168 Ngagra Kadastrale P - 72514036-00589-219 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.169 Ngagra Kadastrale P - 72514036-00589-300 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.170 Ngagra Kadastrale P - 72514036-00589-1004 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë;
- 1.171 Ngagra Kadastrale P - 72514036-15744-1 - Zona Kadastrale Fushë-Kosovë.

2. Pronat e evidentuara në paragrafin një (1), nën paragrafët nga 1.1 deri në 1.171, shpallen me interes publik për projekteve të infrastrukturës sociale: çerdheve, shkollave, objekteve shëndetësore, objekteve kulturore dhe sportive, objekteve të shërbimeve publike - për shërbimet e tregut, **shërbimet për ndërmarrjen publike komunale, shërbimet për Njësinë e Zjarrëfiksëve dhe** Infrastrukturën Rrugore - rregullimin dhe zgjerimin e rrugëve në vende të ndryshme, në territorin e komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e gjashtë (6) - Propozimin për ndihmë financiare të fëmijëve me autizëm dhe sindromin down.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për ndihmë financiare të fëmijëve me autizëm dhe sindromin down’, ftoi Drejtoreshën për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që të na jap sqarime.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Faleminderit Kryesues, duke u bazuar në nenin 12, nenin 124 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që garantojnë kompetencat e Vetëqeverisjes Lokale dhe mbrojtjen sociale të qytetarëve, nenit 17, pika 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, i propozojmë Kuvendit të Komunës të Fushë-Kosovës, që të miratoi propozimin për ndihmë financiare mujore në shumë prej: 100.00€ për fëmijët me autizëm dhe sindromin doën, banorë të Fushë-Kosovës. Bazuar në kompetencat ligjore të Komunës së Fushë-Kosovës, në fushën e mbrojtjes sociale dhe ofrimit të shërbimeve, për kategoritë e cënueshme dhe duke marrë parasysh nevojën për rehabilitim, trajtim dhe mbështetje sociale të fëmijëve me sindromin down dhe autizëm, ndarja e mbështetjes financiare mujore, paraqet masë administrative të ligjshme, të arsyeshme për sigurimin e mirëqenies sociale, mbrojtjen e interesit publik dhe lehtësimin e barrës ekonomike për familjet përfituese. Mjetet financiare për këtë financim, do të bëhen nga subvencionet dhe transferet. Ju ftoj ta përkrahni këtë propozim.

Kosovar Ademi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e mbështet fuqishëm këtë propozim dhe kërkojmë miratimin e tij edhe nga subjektet tjera politike.

Mirlinda Krasniqi: Faleminderit Kryesues, para vetës kemi një propozim që prek familjet që përballen çdo ditë me kujdesin ndaj fëmijëve me sindromin down dhe autizëm, mbështetja financiare prej: 100.00€ është një hap i mirë dhe i domosdoshëm, por realiteti na tregon se kjo shumë nuk e mbulon barrën reale ekonomike, që këto familje kanë. Këta fëmijë kanë nevojë të vazhdueshme për terapi zhvillimore, materiale, higjienike, kontrole të shpeshta mjekësore dhe medikamente. Shpenzimet mujore e kalojnë disa herë shumën, që ne po e ndajmë, prandaj duke pasur parasysh rritjen e kostos së jetesës si Grup Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozojmë rritjen nga 100.00€, në 150.00€, duke e votuar këtë rritje dëshmojmë se komuna jonë, nuk e lënë askend pas dhe solidariteti social, është prioritet real.

Aida Alimi: Faleminderit Kryesues, në emër të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, do ta mbështesim këtë propozim, po ashtu edhe në emër të Grupit të Grave të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, do të kërkojmë që në të ardhmen të ndërtohet, edhe një qendër për këta fëmijë, është shumë i qëlluar propozimi.

Ali Ismaili: I nderuar Kryesues, të nderuar kolegë pa dyshim, që duhet të mbështesim këto kategori, jam dakord me Lidhjen Demokratike të Kosovës, që të rritet kjo shumë e mjeteve financiare prej: 150.00€ nëse ka mundësi, duhet të dimë si asambleistë sa është kostoja e këtij propozimi dhe a ka ndonjë listë Komuna e Fushë-Kosovës, se sa familje i kemi që kanë fëmijë me nevoja të veçanta, sepse duhet me qenë një databazë. Ne si asambleistë duhet të dimë koston e këtij propozimi, sepse ju keni një buxhet të trashëguar Drejtoreshë e nderuar, për ndryshe ju përgëzoi për iniciativën.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Pajtohem me asambleistën znj. Mirlinda Krasniqi, që këta fëmijë kanë nevoja të mëdha dhe kjo shumë është simbolike, mirëpo duke marrë parasysh se në Kuvend të Kosovës, është në shqyrtim ligji gjithpërfshirës për personat me nevoja të veçanta, derisa të miratohet ky ligj, na po e marrim një masë lehtësuese për këto kategori. Sa i përket shumës totale, sa ka me qenë kostoja, do të jetë përafërsisht 80,000.00€, kemi disa informacione nga Qendra për Punë Sociale që janë diku rreth 70 fëmijë me autizëm dhe sindrom doën, mirëpo do të bëhet një Komision profesional për shqyrtimin dhe verifikimin e këtyre rasteve, aty do të dijmë numrin e saktë të rasteve dhe totalin sa do kushtojë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, rekomandimi është kështu: për procedim, shqyrtim në Kuvendin e Komunës të propozimit për ndihmë financiare për fëmijët me autizëm dhe sindromin down në shumën e mjeteve financiare prej: 100.00€ dhe transferimin e tyre çdo tre muaj nga kategoria suvencione në shëndetësi, me qenë se është hera e parë në komunën tone, që bëhet një subvencionim i tillë, ka mundësi që në të ardhmen të rritet kjo shumë, ne si Kuvend i Komunës e marrim iniciativën, por për fillim të votojmë këtë propozim nga Ekzekutivi i Komunës.

Laureat Gojnovci: Ne sot e kemi një qeveri e cila me Ligjin e buxhetit, ka proklamuar një rritje edhe te rasteve sociale, edhe pensioneve dhe nëse ka buxhet, pse mos të niset me një shumë më të madhe, që të ju lehtësohet barra familjeve.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Ende nuk e dimë numrin e saktë të këtyre fëmijëve dhe duhet të subvencionojmë edhe persona që kanë sëmundje tjera, andaj të fillojmë me shumën e mjeteve financiare prej: 100.00€ me mundësi të rritjes.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare prej: 100.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe

transfereve Nr. (200), programi Administrata e Shëndetësisë Nr. 73011, për fëmijët me Autizëm dhe Sindromën Dawn, banorë të Komunës së Fushë-Kosovës’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës, me unanimitet të votave e aprovuan ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare prej: 100.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve Nr. (200), programi Administrata e Shëndetësisë Nr. 73011, për fëmijët me Autizëm dhe Sindromën Dawn, banorë të Komunës së Fushë-Kosovës’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për lejimin e mjeteve financiare prej: 100.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve Nr. (200), programi Administrata e Shëndetësisë Nr. 73011, për fëmijët me Autizëm dhe Sindromën Dawn, banorë të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Shpenzimi i mjeteve financiare nga paragrafi një (1) i këtij vendimi, do të realizohet sipas planit dinamik të shpenzimeve mujore / tremujore të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nga një qind euro për secilin muaj dhe shpërndarjen e tyre tek fëmijët me Autizëm dhe Sindromën Dawn.

Pika e shtatë (7) - Raportin e Auditimit të jashtëm dhe pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.

Kryesuesi i kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim ‘Raportin e Auditimit të jashtëm dhe pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024’, fjala është për z. Shyqeri Krasniqi - nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Shyqeri Krasniqi - Njësia e Auditimit të Brendshëm: Përhëndetje për të gjithë, po fillojmë me pikën e rendit të ditës ‘Raporti i pasqyrave financiare vjetore të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024’, fillimisht po e cekim se Komuna ka për obligim që për raportin e pasqyrave financiare, të përpilojë ‘Planin e zbatimit të rekomandimeve’, që përpilohet pas pranimit dhe të përpilojë raportin e progresit pas tre muajve, muajin e nëntë, edhe në janar deri me 31 dhjetor të vitit fiskal. Më parë këtë raport Komuna nuk e ka përpiluar, pra planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Tani ne kemi përpiluar me 31 dhjetor, raportin e zbatimit të rekomandimeve, gjegjësisht raporti i progresit. Raporti i pasqyrave për vitin 2024, është marrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe na mundëson të jepim një opinion lidhur me pasqyrat financiare, raporti përmban pasqyrën e pranimeve, pagesave me para të gatshme, raportin e Ekzekutimit të Buxhetit dhe politika të rëndësishme të kontabilitetit dhe raporte tjera për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024. Opinion i kualifikuar për pasqyrat vjetore ipet në raste kur keq-deklarohen të dhënat në pasqyra dhe kemi mospërputhje, e tejkalojnë nivelin e materialitetit, pra zbatohet kur problemet janë materiale. Sipas pikës B1, nga kategoritë ekonomike joadekuat janë realizuar pagesa 899,000.00€, kurse A1, është prezantimi jo i drejtë i buxhetit final të rezervave në vlerë prej 80,000.00€ dhe shpalosja jo e drejtë e detyrimeve kontigjente, kurse bazë për konkluzione janë pika A2, tani 5 kontrata ishin bërë pagesa për punë që ende nuk kishin përfunduar. Pika A3, në gjashtë raste projektet kapitale nuk ishin bërë vazhdimi i sigurimit të ekzekutimit të kontratave dhe në dy raste nuk kishte ofruar garancionin bankar për kualitetin e punëve. Pika A4, në dy raste kapitali i projektit ishte nënshkruar kontrata me vlera më të mëdha, se vlera e buxhetit, pika B2 në një rast procedurat e prokurimit të tenderit, fituesi i tenderit nuk kishte përmbushur njërin nga kriteret. Pika B3, në 7 raste në vlerë prej: 34,000.00€, subvencionet nuk ishin bërë në pajtim me Rregulloren dhe thirrjen publike, pika

B4, 7 fatura në vlerë prej: 46,000.00€ pagesat janë vonuar përtej afateve ligjore 30 ditë, pika B5, komuna nuk ishte arritur të bëjë verifikimin e së paku 20% të pronave të paluajtshme. Pika A3, mos monitorimi i projekteve suvencioneve dhe mos raportimi financiar dhe narrativ nga 3 Organizata Jo Qeveritare përfituese, pika A6, mos përfshirja e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në procedurat e rekrutimit në tri raste, pika A7, vonesa në realizimin e projekteve kapitale dhe mos vlerësimin e performancës së kontraktuesve në modulën e menaxhimit të kontratave. Kontratat e qerasë për pronat komunale nga shfrytëzuesit, dobësi në llogari të argëtueshme, B6 dhe B7, mos funksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe mos formimi i Komitetit të Auditimit. Këto ishin pikat e raportit të auditorit të përgjithshëm, kurse gjendja e rekomandimeve në komunën tone, është prej 15 rekomandimeve, 8 janë të reja, 7 të vjetra të përsëritura, pra gjendja e tyre është 8 rekomandime të zbatuara, 5 pjesërisht, ndërsa të pa zbatuara janë 2.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Falënderit z. Shyqeri Krasniqi, ne po e tejkalojmë këtë pikë lidhur me 'Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2024'.

Pika e tetë (8) - Raporti i Auditimit të përfundimit në procesin e lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi edhe 'Raportin e auditimit të përfundimit në procesin ndërtimor në Komunën e Fushë Kosovës', sepse janë vetëm informata siç kanë ardhur në material, nëse s'ka dikush me thënë diçka po kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, meqë të dhënat për procesin e lejeve ndërtimore janë në raport të përshkuara.

Pika e nëntë (9) - Informatë për Performancën Komunale për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi 'Informatën për performancën komunale në vitin 2024', e cila shërben për me u ranguar në mesin e Komunave të Kosovës, në raport me performancë, kjo në shërben që në raportin e performancës të notohemi me 10 pikë më shumë për vitet e ardhshme, a ka dikush të shtoj diçka për këtë pikë, edhe këtu shënimet e pasqyrojnë gjendjen reale që ka ndodhur në vitin 2024.

Pika e dhjetë (10) - Propozim për shqyrtimin e Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Propozimin për shqyrtimin e 'Projekt-Planit vjetor të Kuvendit të Komunës për vitin 2026', rekomandimet janë dhënë, janë marrë parasysh, nëse nuk ka ndonjë çështje shtesë e qesim në votim për miratim planin e punës me përmirësime.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Projekt- Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Propozim për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Komunitete. Sqaroi numrin e anëtarëve dhe propozimet që duhet të jepen.

Kosovar Ademi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, propozon anëtare për këtë komitet është znj. Besarta Qadraku.

Laureat Gojnovci: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozon anëtar për këtë komitet është z. Afrim Dumani.

Migjen Kolshi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, propozon anëtare për këtë komitet është znj. Aida Alimi.

Rrahim Tërnavaj: Unë propozoi për anëtar të Komitetit për Komunitete z. Ermal Dumani.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Falënderit, te Nisma Socialdemokrate, nënkuptohet është z. Driton Ademi, përfaqësuesi i Partisë Egjiptiane është z. Bashkim Krasniqi, përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës është z. Dashnim Bajrami, përfaqësuesi i Listës Serbe është z. Radoman Doderovic, edhe përfaqësuesi i komunitetit ashkali jashtë Kuvendit të Komunës është znj. Xheneta Bajrami dhe komuniteti romë e ka dërguar emrin e komunitetit rom jashtë Kuvendit të Komunës znj. Kimete Gashi. Tani me qenë se nga Partia Demokratike të Kosovës, i kemi dy propozime po shkojmë me votim një nga një për anëtarët e propozuar.

- Kush është 'për' propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtare të Komitetit për Komunitete znj. Besarta Qadraku - votohet unanimitisht nga të pranishmit.
- Kush është 'për' propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar të Komitetit për Komunitete z. Afrim Dumani - votohet unanimitisht nga të pranishmit.
- Kush është 'për' propozimin e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare të Komitetit për Komunitete znj. Aida Alimi - u votua me: dhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe shtatëmbëdhjetë abstenime, gjithsej njëzet e shtatë pjesëmarrës në votim, andaj ky propozim nuk kalon.
- Kush është 'për' propozimin e z. Ermal Dumanin si anëtar i Komitetit për Komunitete – njëzet e një vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim.
- Kush është 'për' propozimin e Nisma Socialdemokrate, anëtar të Komitetit për Komunitete z. Driton Ademi - votohet unanimitisht nga të pranishmit.
- Kush është 'për' propozimin e Partisë Liberale Egjiptiane, anëtar të Komitetit për Komunitete z. Bashkim Krasniqi - votohet unanimitisht nga të pranishmit.
- Kush është 'për' propozimin e Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, anëtar të Komitetit për Komunitete z. Dashnim Bajrami - votohet unanimitisht nga të pranishmit.
- Kush është 'për' propozimin e Komitetit ashkalinjë jashtë Kuvendit të Komunës, për anëtare të Komitetit për Komunitete znj. Xheneta Bajrami - njëzet e katër vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim.
- Kush është 'për' propozimin e Komitetit romë jashtë Kuvendit të Komunës, për anëtare të Komitetit për Komunitete znj. Kimete Gashi - votohet unanimitisht nga të pranishmit.

Kush është 'për' votimin e të gjithë emrave të cekur më lartë, me përjashtim të znj. Aida Alimi, e cila nuk ka kaluar si propozim.

U votua unanimit nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të Kuvendit të Komunës, pjesëmarrës në votim, nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me votim unanimit të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Komunitete në përbërje prej nëntë anëtarëve si vijon: Besarta Qadraku, Afrim Dumani, Ermal Dumani, Driton Ademi, Bashkim Krasniqi, Dashnim Bajrami, Xheneta Bajrami dhe Kimete Gashi' dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej nëntë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Besarta Qadraku - Lëvizja Vetëvendosje, anëtare e Kuvendit të Komunës;
 - 1.2 Afrim Dumani - Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.3 Ermal Dumani - Partia Demokratike e Kosovës, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.4 Driton Ademi - Nisma Socialdemokrate, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.5 Bashkim Krasniqi - Partia Liberale Egjiptiane - përfaqësues i Komitetit egjiptian, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.6 Dashnim Bajrami - Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës - përfaqësues i Komitetit ashkali, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.7 Radoman Doderovic - Lista Serbe - përfaqësues i Komitetit serb, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.8 Kimete Gashi - përfaqësuese e Komitetit romë, anëtare jashtë Kuvendit të Komunës dhe
 - 1.9 Xheneta Bajrami - përfaqësuese e Komitetit ashkali, anëtare jashtë Kuvendit të Komunës.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komitetit për Komunitete, përgjegjësia për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatimin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'iu siguruar, se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht, Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndër mirren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për tu avansuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate, të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, me emrin nga Lidhja Demokratike e Kosovës, për plotësimin e këtij komiteti me z. Laureat Gojnovci.

Laureat Gojnovci: Kryesues, tani unë e propozoi vetën në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kush është 'për' propozimin e z. Laureat Gojnovci

U votua unanimit nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë pjesëmarrës në votim, nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me votim unanimit të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Propozimin për plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të z. Laureat Gojnovci përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e vendimit Nr. 13, të datës 28.01.2026 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në paragrafin një, shtohet nën - paragrafin 1.4, me caktimin e anëtarit të shtatë të komitetit z. Laureat Gojnovci, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komitetit për Politikë dhe Financa, është shqyrtimi i të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raportit nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Pika e trembëdhjetë (13) - Propozim për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim ‘Propozimi për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik’, ku kemi një kërkesë nga Partia Demokratike e Kosovës, kanë kërkuar që përfaqësuesin e tyre me largojmë prej zhvillimit ekonomik, e me vendos tek Komiteti i Arsimit, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje me e larguar përfaqësuesin e tyre nga arsimit, e me sjellë tek zhvillimi ekonomik anëtarin e saj. Lëvizja Vetëvendosje i ka dy anëtar te ky komitetë, ndërsa Partia Demokratike të Kosovës, nuk ka anëtar, kështu që e ftoj Lëvizjen Vetëvendosje, t’i jap emërat e anëtarëve të Komitetit për Zhvillim Ekonomik.

Filloreta Musaj: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, propozon z. Daut Krasniqi dhe z. Hajredin Mjeku, kurse jashtë Kuvendit të Komunës janë: znj. Serafina Firza dhe z. Genc Osmani.

Laureat Gojnovci: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozon z. Jetmir Berisha.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Falënderit, kush është ‘për’, këto propozime që erdhën në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon: Daut Krasniqi, Hajredin Mjeku, Jetmir Berisha dhe jashtë Kuvendit të Komunës Serafina Firza dhe Genc Osmani.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë pjesëmarrës në votim, nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e propozoi ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon: Daut Krasniqi, Hajredin Mjeku, Jetmir Berisha dhe jashtë Kuvendit të Komunës Serafina Firza dhe Genc Osmani’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Daut Krasniqi - Lëvizja Vetëvendosje, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.2 Jetmir Berisha - Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.3 Hajredin Mjeku – Lëvizja Vetëvendosje, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.4 Serafina Firza - anëtare jashtë Kuvendit të Komunës dhe
 - 1.5 Genc Osmani - anëtare jashtë Kuvendit të Komunës.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Fushë-Kosovës, janë të definuara në nenin 5, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Pika e katërbëdhjetë (14) - Propozim për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Infrastrukturë Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimi për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Infrastrukturë, Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit, ftoj Lëvizjen Vetëvendosje, të jap emërat edhe të ekspertëve të jashtëm.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e propozojmë z. Kushtrim Mirena dhe anëtarë jashtë Kuvendit të Komunës z. Visar Reçica dhe z. Rina Dervisholli.

Ermal Dumani: Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës e propozojmë z. Rrahim Tërnavë.

- Kush është 'për' propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar të Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Infrastrukturë, Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit, z. Kushtrim Mirena - votohet unanimisht nga të pranishmit, pjesëmarrës në votim, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë.
- Kush është 'për' propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare të Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Infrastrukturë, Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit, znj. Mirlinda Krasniqi - votohet unanimisht nga të pranishmit, pjesëmarrës në votim, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë.
- **Kush është 'për' propozimin e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar të Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Infrastrukturë, Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit, z. Rrahim Tërnavë - votohet unanimisht nga të pranishmit, pjesëmarrës në votim, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë.**
- Kush është 'për' propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtare jashtë Kuvendit të Komunës në Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër, Infrastrukturë, Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit, znj. Rina Dervisholli - votohet unanimisht nga të pranishmit, pjesëmarrës në votim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë.
- Kush është 'për' propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar jashtë Kuvendit të Komunës në Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër, Infrastrukturë, Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit, z. Visar Reçica - votohet unanimisht nga të pranishmit, pjesëmarrës në votim, gjithsej shtatëmbëdhjetë anëtarë.
- Kush është 'për' propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar jashtë Kuvendit të Komunës në Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër, Infrastrukturë, Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit, z. Ilir Hasani - votohet me njëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, pjesëmarrës në votim, gjithsej njëmbëdhjetë anëtarë, andaj ky propozim nuk kalon.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: pas votimit theksoi se me unanimitet të votive të pjesëmarrësve në votim aprovohen këto propozime që erdhën në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon: Kushtrim Mirena, Mirlinda Krasniqi, Rrahim Tërnavë, Visar Reçica dhe Rina Dervisholli dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Infrastrukturë Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Kushtrim Mirena - Lëvizja Vetëvendosje, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.2 Mirlinda Krasniqi - Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare e Kuvendit të Komunës;

1.3 Rrahim Tërnavë - Partia Demokratike e Kosovës, anëtar i Kuvendit të Komunës;

1.4 Visar Reçica - anëtar jashtë Kuvendit të Komunës dhe

1.5 Rina Dërvisholli - anëtare jashtë Kuvendit të Komunës.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Infrastruktura Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Fushë-Kosovës, janë të definuara në nenin 6, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Propozim për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport'. Tani kërkojmë nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, që të jepni emërat ju lutem dhe rekomandimet për eksperta të jashtëm.

Fillorata Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e propozojmë për këtë komitet z. Burim Berisha, ndërsa eksperte të jashtme i propozojmë znj. Amine Demiri dhe znj. Kosovare Fetahu.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e propozojmë z. Ali Topalli.

Valon Murseli: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, e propozojmë z. Migjen Kolshi.

Bashkim Krasniqi: Unë për këtë komitet dua të propozoj znj. Vlora Gashi, është mësimdhënëse.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Mirë, vazhdojmë me hedhjen në votim të emërave,

- Kush është 'për' propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, z. Burim Berisha - votohet unanimisht nga të pranishmit, pjesëmarrës në votim, gjithsej njëzet e tre anëtarë.
- Kush është 'për' propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, z. Ali Topalli - votohet unanimisht nga të pranishmit, pjesëmarrës në votim, gjithsej njëzet e tre anëtarë.
- Kush është 'për' propozimin e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, z. Migjen Kolshi - votohet unanimisht nga të pranishmit, pjesëmarrës në votim, gjithsej njëzet e tre anëtarë.
- Kush është 'për' propozimin që jashtë Kuvendit të Komunës si eksperte të jetë, anëtare të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Amine Demiri - votohet unanimisht nga të pranishmit, pjesëmarrës në votim, gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë.
- Kush është 'për' propozimin që jashtë Kuvendit të Komunës si eksperte të jetë, anëtare të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Kosovare Fetahu - votohet unanimisht nga të pranishmit, pjesëmarrës në votim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë.
- Kush është 'për' propozimin që jashtë Kuvendit të Komunës si eksperte të jetë, anëtare të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Vlora Gashi - pjesëmarrës në votim njëmbëdhjetë anëtarë, prej tyre dhjetë vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas votimit theksoi se me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim aprovohen këto propozime që erdhën në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon: Burim Berisha, Ali Topalli, Migjen Kolshi, Amine Demiri dhe Kosovare Fetahu dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon:

- 1.1 Burim Berisha - Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.2 Ali Topalli - Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.3 Migjen Kolshi - Partia Demokratike e Kosovës, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.4 Amine Demiri - anëtare jashtë Kuvendit të Komunës dhe
 - 1.5 Kosovare Fetahu - anëtare jashtë Kuvendit të Komunës.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Fushë-Kosovës, janë të definuara në nenin 7, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Pika e gjashtëmbëdhjetë (16) - Propozim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani jemi në shqyrtim të Propozimit për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ftoj përfaqësuesin e Lëvizjes Vetëvendosje, jepni emërin e anëtarit të Kuvendit të Komunës dhe emërat e ekspertëve jashtë Kuvendit të Komunës.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e propozojmë për këtë komitet znj. Arlinda Mekolli, ndërsa eksperte të jashtme i propozojmë znj. Hasime Kostanica dhe znj. Diellza Bllaca.

Vjosa Kida Hyseni: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e propozojmë për këtë komitet znj. Saranda Sllamniku.

Migjen Kolshi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, e propozojmë për këtë komitet z. Valon Murseli.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po i qesim në votim 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon: Arlinda Mekolli, Hasime Kostanica, Diellza Bllaca, Saranda Sllamniku dhe Valon Murseli'.

U votua me: njëzet vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të voatave e aprovoi 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon: Arlinda Mekolli, Hasime Kostanica, Diellza Bllaca, Saranda Sllamniku dhe Valon Murseli' dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Arsim Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Arlinda Mekolli - Lëvizja Vetëvendosje, anëtare e Kuvendit të Komunës;
 - 1.2 Saranda Sllamniku - Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare e Kuvendit të Komunës;
 - 1.3 Valon Murseli - Partia Demokratike e Kosovës, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.4 Hasime Kostanica - anëtare jashtë Kuvendit të Komunës dhe
 - 1.5 Diellza Bllaca - anëtare jashtë Kuvendit të Komunës.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Fushë-Kosovës, janë të definuara në nenin 8, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Pika e shtatëmbëdhjetë (17) - Propozimi për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në shqyrtim 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra', ftoi përfaqësuesen e Lëvizjes Vetëvendosje që të propozon emërin e anëtarit të Kuvendit të Komunës dhe emërat e ekspertëve jashtë Kuvendit të Komunës.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e propozojmë për këtë komitet z. anëtarin e Kuvendit të Komunës z. Kosovar Ademi dhe emërat e ekspertëve jashtë Kuvendit të Komunës znj. Halime Rudari Mjeku dhe z. Hamdi Bogiqi.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e propozojmë për këtë komitet z. anëtarin e Kuvendit të Komunës znj. Vjosa Kida Hyseni.

Përfaqësuesi i PDK: Nuk ka emër brenda Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në mbledhjen tjetër keni mundësi me plotësuar këtë emër nga Partia Demokratike e Kosovës. Tani e qesim në votim 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra, në përbërje prej katër anëtarëve si vijon: Kosovar Ademi, Vjosa Kida Hyseni, Halime Rudari Mjeku dhe Hamdi Bogiqi'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra, në përbërje prej katër anëtarëve si vijon: Kosovar Ademi, Vjosa Kida Hyseni, Halime Rudari Mjeku dhe Hamdi Bogiqi' dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Kosovar Ademi - Lëvizja Vetëvendosje, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - 1.2 Vjosa Kida Hyseni - Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare e Kuvendit të Komunës;
 - 1.3 Përfaqësuesi/sja e Partisë Demokratike e Kosovës, anëtar/e e Kuvendit të Komunës;
 - 1.4 Halime Rudari Mjeku - anëtare jashtë Kuvendit të Komunës dhe
 - 1.5 Avdi Bogiqi - anëtar jashtë Kuvendit të Komunës.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra në Komunën e Fushë-Kosovës, janë të definuara në nenin 10, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Pika e tetëmbëdhjetë (18) - Propozim për shqyrtimin e kërkesave për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, në konsultim me Kryetarin e Komunës, propozon shqyrtimin e kërkesës së datës 10.02.2026, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, ku definohen shpenzimet e varrimit për qytetarët me vendbanim në Komunën e Fushë-Kosovës, shpenzimet do të mbulohen edhe për banorët e Fushë-Kosovës të komunitetit serbë, mjetet financiare do të merren nga kategoria ekonomike suvencione dhe transfere, prej programit Infrastruktura Publike me Nr. 18162, propozimit i bashkangjitet materiali përcjellës, të cilin e kemi marrë me kërkesën e Bashkësisë Islame, unë po e hapi diskutimin ftoi Lëvizjen Vetëvendosje.

Kosovar Ademi: Ne e mbështesim këtë propozim për aprovim të shpenzimeve për ceremoni të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës.

Laureat Gojnovci: Ne e mbështesim këtë propozim për aprovim të shpenzimeve për ceremoni të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovë.

Valon Murseli: Ne e mbështesim këtë propozim për aprovim të shpenzimeve për ceremoni të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e qesim në votim për aprovim ‘Rekomandimin e katërmbëdhjetë me Nr. 57, të datës 18.02.2026, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për banorët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Fushë-Kosovës, me dokumentacion personal të identifikimit, në shumën e mjeteve financiare prej 470.00€ për një ceremoni të varrimit, duke përfshirë të gjitha komunitetet fetare për vitin 2026’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi ‘Rekomandimin e katërmbëdhjetë me Nr. 57, të datës 18.02.2026, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për banorët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Fushë-Kosovës, me dokumentacion personal të identifikimit, në shumën e mjeteve financiare prej 470.00€ për një ceremoni të varrimit, duke përfshirë të gjitha komunitetet fetare për vitin 2026’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e rekomandimit të katërmbëdhjetë me Nr. 57, të datës 18.02.2026, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për banorët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Fushë-Kosovës, me dokumentacion personal të identifikimit, në shumën e mjeteve financiare prej 470.00€ për një ceremoni të varrimit, duke përfshirë të gjitha komunitetet fetare për vitin 2026.
2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas paragrafit një (1) të vendimit, bëhet nga buxheti i komunës për vitin 2026, kategoria e subvencioneve dhe transfereve Nr. (200), programi buxhetor Infrastruktura Publike Nr. 18162.

Pika e nëntëmbëdhjetë (19) - Propozim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin 2025-2029.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin 2025-2029’, në përbërje si vijon: Valon Prebreza - Kryetar i Komunës, Bekim Zogjani - Komandant i Stacionit të Policisë, Përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame, Përfaqësuesi i Kishës Ortodokse Serbe, Përfaqësuesit e Komuniteteve ashakali, egjiptian, serbë dhe romë, Adriatik Zeqiri - Drejtori për Arsim, Izja Mjeku - Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ejup Qyqalla - përfaqësues i emergjencave civile, Përfaqësuesi i EVSB dhe nga një përfaqësues i KLSP-ve, Lindita Dervisholli Prebreza - Zyrtare për Barazi Gjinore, Sllaxhana Lazic - Shefja e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, nga një përfaqësues i mediave, bizneseve, personave me aftësi të kufizuar dhe shoqërisë civile.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, jemi që të aporvohet ‘Propozimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi’.

Laureat Gojnovci: Nuk kemi diçka për të shtuar, në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, jemi që të aporvohet ‘Propozimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi’.

Migjen Kolshi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, jemi që të aporvohet 'Propozimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Atëherë po e qesim në votim për aprovim 'Propozimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029, sipas propozimeve të ofruara'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votive e aprovoi 'Propozimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029, sipas propozimeve të ofruara' dhe mori:

V E N D I M


1. Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Fushë Kosovës për mandatin zgjedhor 2025-2029.
2. Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Fushë-Kosovës përbëhet prej:
 - 2.1 Valon Prebreza - Kryetar i Komunës - Kryesues i Këshillit;
 - 2.2 Bekim Zogjani - Komandant i Stacionit Policor në Fushë-Kosovës;
 - 2.3 Një përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
 - 2.4 Nexhat Tërnavë - Përfaqësues i Bashkësisë Islame, anëtar;
 - 2.5 Nikolla Dragicevic - Përfaqësues i Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë, anëtar;
 - 2.6 Gëzim Gara - Përfaqësues i Komunitetit ashkali, anëtar;
 - 2.7 **Bashkim Krasniqi - Përfaqësues i Komunitetit egjiptian, anëtar;**
 - 2.8 Boban Filipovic - Përfaqësues i Komunitetit serbë, anëtar;
 - 2.9 Fehmi Gashi - Përfaqësues i Komunitetit romë anëtar;
 - 2.10 Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, pa zgjedhjes, anëtar;
 - 2.11 Lindita Dervisholli Prebreza - Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, anëtare;
 - 2.12 Adriatik Zeqiri - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, anëtar;
 - 2.13 Përfaqësuesi i Këshillit të Prindërve, anëtar;
 - 2.14 Izja Mjeku - Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, anëtar;
 - 2.15 Ejup Qyqalla - Përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale, anëtar;
 - 2.16 Sllaxhana Lazic - Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtare;
 - 2.17 Një përfaqësuesi i Ekipit Komunal për Siguri në Bashkësi, anëtar;
 - 2.18 Përfaqësuesi i Mediave, anëtar;
 - 2.19 Përfaqësuesi i Biznesit, anëtar;
 - 2.20 Lirije Cakaj Shehu - Përfaqësuesi e Organizatave Jo Qeveritare, anëtare;
 - 2.21 Agim Jashari - Përfaqësuesi i personave me nevoja të veçanta, anëtar
 - 2.22 Nga një përfaqësues/se e secilit Këshill Lokal për Siguri Publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës - anëtar/e.
3. Këshilli Komunal për Siguri në bashkësi është përgjegjës për kryerjen e detyrave dhe punëve të caktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të brendshme dhe Nr. 03/2012 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për Këshillat Komunale për Siguri në bashkësi dhe për punën e tij e informon Kuvendin e Komunës.

Pika e njëzet (20) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A keni dikush për të shtruar ndonjë çështje për diskutim. Nëse jo atëherë falënderit shumë, ju uroj muajin e Shenjë të Ramazanit të gjithë besimtarëve musliman, shihemi në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 17:10 minuta.

**Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci**



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**

